



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 180 Akti

Nr. 308 Vendimi
Tiranë, më 14.10.2020

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

Genta Tafa (Bungo) Kryesuese
Suela Zhegu Relatore
Etleda Çiftja Anëtare

asistuar nga sekretare gjyqësore, znj. Etmonda Hoxha, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Steven Kessler, në datën 9.10.2020, ora 09:30, në Pallatin e Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0 (*underground*), Tiranë, mori në shqyrtim në seancë dëgjimore publike çështjen që i përket:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT: **Znj. Pranvera Pustina**, me detyrë prokurore/Drejtoreshë Kabineti në Prokurorinë e Përgjithshme.

OBJEKTI: **Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.**

BAZA LIGJORE: **Pika 5 e nenit 179/ b të Kushtetutës, pika 1 e nenit 7 dhe nenet D, DH dhe E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë**, miratuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998 “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar”;

Ligji nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

Ligji nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;

Ligji nr. 49/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,

pasi dëgjoi arsyetimin ligjor dhe rekomandimin e relatores së çështjes, mori në shqyrtim dhe analizoi provat shkresore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit kryesisht, si dhe shqyrtoi e analizoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I. FAKTET DHE RRETHANAT E ÇËSHTJES

1. Subjekti i rivlerësimit, znj. Pranvera Pustina, me detyrë prokurore/Drejtores Kabineti, në Prokurorinë e Përgjithshme, në bazë të pikës 3, të nenit 179/b, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, i është nënshtruar rivlerësimit *ex officio*, duke u shortuar si subjekt me shortin e hedhur në datën 15.9.2018, në përputhje me rregulloren “Për procedurat e zhvillimit të shortit në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit”.

2. Në mbledhjen e trupit gjykues të datës 16.9.2018 u caktua me mirëkuptim kryesues i trupit gjykues znj. Genta Tafa (Bungo). Në respektim të legjislacionit në fuqi mbi parandalimin e konfliktit të interesit u deklarua mospasja e konfliktit të interesit nga anëtarët e trupit gjykues, si dhe u vendos fillimi i hetimit administrativ nga relatori i çështjes. Vëzhgues ndërkombëtar për këtë subjekt rivlerësimi është caktuar z. Steven Kessler.

3. Procesi i rivlerësimit të pasurisë për subjektin e rivlerësimit, në përputhje me kreun IV, “Vlerësimi i pasurisë”, të ligjit nr. 84/2016 dhe, veçanërisht, me nenin 30 të këtij ligji, ka për objekt vlerësimin, deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të ligjshmërisë së burimit të krijimit të tyre, të përmbushjes së detyrimeve financiare, përfshirë interesat private për subjektin e rivlerësimit dhe për personat e lidhur të tij.

4. Bazuar në nenet 33, 39 dhe 43, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit janë administruar raportet e hartuara nga institucionet, si: Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim ILDKPKI); Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Kualifikuar (në vijim DSIK) dhe Prokuroria e Përgjithshme (në vijim PP).

5. ILDKPKI-ja, në përputhje me nenin 33, të ligjit nr. 84/2016, pasi ka kryer një procedurë kontrolli për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, ka dërguar një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar¹, duke konkluduar se:

- *deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin;*
- *ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;*
- *nuk ka kryer fshehje të pasurisë;*
- *nuk ka kryer deklarim të rremë;*
- *subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*

6. DSIK-ja ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikonte nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjin nr. 84/2016, si dhe ka dërguar një raport të arsyetuar², duke konkluduar mbi “*përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit, Pranvera Resmi Pustina*”.

7. Prokuroria e Përgjithshme ka kryer vlerësimin e aftësive profesionale, duke rishikuar dokumentet ligjore të përpiluara nga subjekti i rivlerësimit gjatë periudhës objekt i rivlerësimit, sipas shtojcës 4, të ligjit nr. 84/2016, si dhe pesë dokumentet e tjera ligjore, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor, si dhe ka dërguar një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar³ mbi subjektin e rivlerësimit.

¹ Raporti nga ILDKPKI-ja i dërguar me shkresën nr. *** prot., datë 22.1.2018.

² Me shkresën nr. **** prot., datë 2.11.2017, dërgohet raporti i DSIK-së, deklasifikuar me vendimin nr. ***, datë 27.9.2018, të KDZH-së nr. ***, datë 27.9.2018.

³ Me shkresën nr. *** prot., datë 18.12.2018, dërgohet raporti i Grupit të Punës në Prokurorinë e Përgjithshme.

8. Në vijim, nga relatori i çështjes janë ndjekur procedurat ligjore të përcaktuara në pikën 5, të nenit 14, të ligjit nr. 84/2016. Procesi i rivlerësimit ka nisur me një hetim administrativ të thellë dhe të gjithanshëm, me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për këtë procedurë rivlerësimi.

9. Trupi gjykues, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, pasi u njoh me raportin dhe rekomandimin e relatorit të çështjes në datën 29.9.2020, vendosi përfundimin e hetimit kryesisht për subjektin e rivlerësimit, znj. Pranvera Pustina, si dhe njoftimin e këtij subjekti për t'u njohur me materialet e dosjes, dokumentet e administruara nga Komisioni dhe rezultatet e hetimit, në përputhje me nenet 35 - 40 dhe 45 - 47 të Kodit të Procedurave Administrative, si dhe duke i kaluar subjektit të rivlerësimit barrën e provës, në përputhje me nenin 52, të ligjit nr. 84/2016, si dhe me nenin D të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

10. Për një proces të rregullt ligjor, znj. Pranvera Pustina i janë garantuar të drejtat, si: për t'u njoftuar për fillimin e procedurës së rivlerësimit; përbërjen e trupit gjykues; si dhe për përfundimin kryesisht të hetimit administrativ, duke i kaluar barrën e provës/shpjegimet mbi rezultatet e hetimit. Në datën 30.9.2020 për sa rezultoi nga hetimi administrativ i procesit të rivlerësimit, subjektit iu dhanë 7 ditë kohë për t'u njohur me dosjen dhe për të disponuar kopje të saj.

11. Znj. Pranvera Pustina, pasi u njoh me rezultatet e hetimit, ka paraqitur shpjegimet dhe provat e saj në datën 6.10.2020. Subjekti i rivlerësimit, lidhur me rezultatet e hetimit deklaroi se është dakord me gjetjet e konstatuara nga hetimi i kryer nga Komisioni. Trupi gjykues, pas shqyrtimit të këtyre shpjegimeve dhe provave të vëna në dispozicion nga subjekti, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, vendosi të ftojë subjektin e rivlerësimit në seancë dëgjimore.

II. SEANCA DËGJIMORE

12. Subjekti i rivlerësimit u ftua në seancë dëgjimore me njoftimin e bërë elektronikisht në datën 7.10.2020.

13. Seanca dëgjimore u zhvilluan në datën 9.10.2020, në përputhje me kërkesat e nenit 55, të ligjit nr. 84/2016, në ambientet e Pallatit të Koncerteve, salla B, kati 0, Tiranë, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Steven Kessler.

14. Në këtë seancë subjekti i rivlerësimit u paraqit dhe u mbrojt personalisht dhe shprehu opinionin e saj në lidhje me procesin e rivlerësimit të kryer. Në përfundim, subjekti i rivlerësimit pranoi rezultatet e hetimit të kryera nga Komisioni dhe kërkoi konfirmimin në detyrë.

III. QËNDRIMI DHE MENDIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT

15. Subjekti i rivlerësimit, znj. Pranvera Pustina, ka qenë bashkëpunuese gjatë procesit të rivlerësimit, në zbatim të nenit 48, të ligjit nr. 84/2016, "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", gjatë gjithë procedurës së hetimit administrativ, ka zbatuar me përpikëri afatet e përcaktuara nga Komisioni. Subjekti i rivlerësimit, znj. Pranvera Pustina, ka qenë korrekte dhe e gatshme për bashkëpunim gjatë të gjitha fazave të hetimit, si dhe gjatë zhvillimit të seancës dëgjimore.

IV. PROCESI I RIVLERËSIMIT/HETIMI I KRYER NGA KOMISIONI

16. Procesi i rivlerësimit, që kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, është një proces kushtetues, që mbështetet në nenin 179/b dhe Aneksin e Kushtetutës, si dhe në ligjin nr. 84/2016. Ky proces kryhet me qëllim që të garantohet funksionimi i shtetit të së drejtës,

pavarësia e sistemit të drejtësisë, me synim rikthimin e besimit të publikut tek institucionet e këtij sistemi.

17. Parashikimet e ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, kanë përcaktuar qartë të gjitha rregullat e posaçme për kryerjen e rivlerësimit mbi bazën e parimeve të barazisë përpara ligjit, të kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë, të proporcionalitetit dhe të parimeve të tjera që garantojnë të drejtën e subjekteve të rivlerësimit për një proces të rregullt ligjor.

18. Sipas kreut IV, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ILDKPKI-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit dhe për të marrë vendim në lidhje me vlerësimin pasuror.

19. Ndërsa, sipas kreut V, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, DSIK-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin e figurës dhe për të marrë vendim në lidhje me kontrollin e figurës.

20. Referuar vendimit nr. 2/2017 të Gjykatës Kushtetuese dhe kreut VII të ligjit nr. 84/2016, ka rezultuar se Komisioni, në kryerjen e funksionit të tij kushtetues, realizon një proces të mirëfilltë kontrolli dhe rivlerësimi, që nuk bazohet dhe as është i detyruar nga përfundimet e paraqitura nga organet e tjera ndihmëse.

21. Bazuar në nenet 45, 49 dhe 50, të ligjit nr. 84/2016, Komisioni kreu hetimin dhe vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në analizë:

- a) provat e dorëzuara nga subjekti në ILDKPKI me “deklaratën e pasurisë për rivlerësimin kalimtar, *Vetting*”;
- b) raportin e dorëzuar në Komision nga ILDKPKI-ja;
- c) deklaratën e rivlerësimit kalimtar *Vetting* dhe deklaratat periodike/vjetore të dorëzuara ndër vite nga subjekti në ILDKPKI;
- d) provat shkresore/dokumentet e administruara nga organet publike dhe private;
- e) raportin e kontrollit të figurës të dorëzuar në Komision nga DSIK-ja;
- f) raportin për vlerësimin e aftësive profesionale të dorëzuar në Komision nga Prokuroria e Përgjithshme;
- g) deklaratimet e subjektit të rivlerësimit me anë të komunikimit elektronik;
- h) shpjegimet me shkrim të subjektit të rivlerësimit të depozituar nëpërmjet postës elektronike dhe ato gjatë seancës dëgjimore për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit.

22. Bazuar në nenin 179/b, në nenet Ç, D, DH dhe E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe në ligjin nr. 84/2016, procesi i rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit, znj. Pranvera Pustina, me detyrë prokurore/Drejtoreshë e Kabinetit, në Prokurorinë e Përgjithshme, u krye mbi bazën e tri kritereve: vlerësimi i pasurisë, kontrolli i figurës dhe vlerësimi i aftësive profesionale.

A. VLERËSIMI I PASURISË

Subjekti i rivlerësimit, znj. Pranvera Pustina, është bërë subjekt deklarues në vitin 2010 dhe në zbatim të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar dhe të ligjit

nr. 9367, datë 10.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike” i ndryshuar, ka dorëzuar ndër vite deklaratat e interesave private për vitet 2010 – 2016, si dhe deklaratën e pasurisë së rivlerësimit kalimtar për efekt të ligjit nr. 84/2016 (siç quhet ndryshe edhe deklarata *Vetting*).

Komisioni, bazuar në ligjin nr. 84/2016, kreu një hetim administrativ të thelluar dhe të gjithanshëm, i cili konsistoi në: verifikimin e vërtetësisë së deklarimeve në lidhje me gjendjen pasurore; burimet e krijimit të kësaj pasurie; të ardhurat; shpenzimet; mundësinë për fshehje të pasurisë dhe deklarim të rremë apo konfliktin e interesit.

Hetimi i Komisionit

Në deklaratën *Vetting*, subjekti ka deklaruar që nuk ka kontribute në krijimin e pasurive të blera nga bashkëshorti dhe për të gjitha pasuritë e blera pas martesë zotëron 50 % të pjesës takuese.

Në deklaratën e pasurisë sipas formularit (shtojca 2) të datës 30.1.2017, subjekti i rivlerësimit, znj. Pranvera Pustina, dhe personat e lidhur me të, kanë deklaruar këto pasuri:

1. Truall ullishte me sipërfaqe 8.700 m² në fshatin M, Tiranë, blerë në dhjetor të vitit 2016, në bashkëpronësi me shtetasin M. M., me ½ pjesë secili

Vlera e deklaruar: 55.000 euro;

Pjesa në përqindje: 50 % e pjesës takuese të bashkëshortit.

Burimi i krijimit: të ardhurat e tatueshme nga llogaritë rrjedhëse.

Deklarimi në DPV: nëpërmjet të ardhurave të tatueshme të bashkëshortit.

Mënyra e fitimit: nëpërmjet kontratës noteriale për shitblerjen e pasurisë së paluajitshme ullishte nr. *****/rep/kol., datë 22.12.2016, pranë notere R. R.

1.1 Faktet e rezultuara nga hetimi administrativ

Nga dokumentacioni i administruar ka rezultuar se bashkëshorti i subjektit zotëron ½ e kësaj pasurie.

ZVRPP-ja Tiranë⁴ ka konfirmuar pasurinë ullishte me sip. 8.700 m², z. k. ***, nr. pasurie ***, në fshatin M .Tiranë, e regjistruar në emër të shtetasve F.P dhe M .M me nga ½ pjesë, duke i bashkëlidhur kartelën e pasurisë.

ALUIZNI⁵- Drejtoria e Përgjithshme nuk jep informacion për ndonjë vetëdeklarim nga subjekti apo personi i lidhur për këtë pasuri.

OSHEE-ja⁶ ka informuar se referuar të dhënave të sistemit të faturimit identifikohet një abonent me nr. kontrate TR*M****, në instancën e Tiranës, në emër të z. F. P, me vendndodhje në M dhe datë hapje kontrate 8.11.2017. Konsumi i energjisë është tarifë fikse, pa konsum energjie.

1.2 Analiza e fakteve

Në dosjen e ILDKPKI-së është administruar dokumentacioni, si vijon:

- kontratë shitblerjeje nr. *****/rep/kol., datë 22.12.2016, ku pala shitëse familja A, përfaqësuar nga z. E. A i shet palës blerëse F. P dhe M.M ullishte me sip. prej 8.700 m², në fshatin M, Tiranë, në vlerën 55.000 euro. Nga çmimi i blerjes, shuma prej 5.000 euro është

⁴ Me shkresën nr. *** prot., datë 20.2.2019.

⁵ Me shkresën nr. ***** prot., datë 14.2.2019.

⁶ Me shkresën nr. ***** prot., datë 21.2.2019.

- paguar në formë kapari më 13.12.2016, sipas kontratës së kaparit dhe kësti i dytë do të paguhej nga blerësit në llogarinë bankare të noterit publik, pas nënshkrimit të kontratës;
- deklaratë noteriale nr. *****/rep/kol., datë 13.12.2016 ku palët: familja A, përfaqësuar nga z. E.A dhe shtetasit F. P dhe M.M deklarojnë se në datën 13.12.2016 kanë nënshkruar një kontratë kapari dhe një kontratë shitjeje përfundimtare për transferimin e pasurisë;
 - kontratë kapari nr. *****, datë 13.12.2016; nenet 8.2 dhe 8.3, palët deklarojnë në vullnetin e tyre të lirë se, nëse shitësit dhe blerësit, deri më 23.12.2016 nuk lidhin para noterit kontratën e shitjes, e cila duhet të firmosej pas përfundimit të procesit të rivlerësimit të pasurisë, atëherë palët autorizojnë noterin, në mënyrë të parevokueshme, që vetëm me kërkesë të blerësit, të noterizojë kontratën e shitjes, e cila në këtë rast hyn në fuqi pa ndryshime në datën 23.12.2016;
 - certifikatë për vërtetim pronësie e datës 16.11.2016 dhe kartelë pasurie për tokë ullishte me sip. 8.700 m² në emër të familjes A (1/5 pjesë secili nga bashkëpronarët);
 - prokurë e posaçme nr. *****/rep/kol., datë 12.12.2016, ku familja A, N, S, A dhe L A emërojnë përfaqësues të posaçëm z. E.A për krytjen e veprimeve të shitblerjes, dhurimit, qirasë, shkëmbimit, të nënshkruajë kontrata para noterit, për pasurinë ullishte me sip. prej 8.700 m², në fshatin M, Tiranë;
 - formular i përlllogaritjes së tatim-fitimit, ku çmimi i shitjes është llogaritur në shumën 7.425.000 lekë.

1.3 Burimi i krijimit

Subjekti, në deklaratën *Vetting*, deklaron se kjo pasuri është blerë me të ardhurat e bashkëshortit. Konkretisht, bashkëshorti i subjektit ka deklaruar se kjo pasuri është blerë me të ardhurat e tatueshme nga llogaritë rrjedhëse, në shumën 55.000 euro. Pjesa takuese e çmimit për z. F. P, për 50 % të pronës është 27.000 euro. Çmimi i blerjes, paguar i plotë nëpërmjet llogarisë së noterit.

Referuar të dhënave bankare ka rezultuar se pagesa është kryer me transfertë bankare:

- nga llogaria në euro e z. F. P, në BKT Shqipëri, ka kaluar më 13.12.2016 shuma prej 2.500 euro, transferuar te llogaria e z. E. A për pagesë kapari sipas kontratës nr. *****/rep/kol., datë 22.12.2016;
- nga llogaria në euro e z. F. P në BKT Shqipëri, ka kaluar më 22.12.2016 shuma prej 25.000 euro transferuar noterës R. R, sipas kontratës nr. *****/rep/kol., datë 22.12.2016.

1.4 Në lidhje me investime të kryera në këtë pasuri, subjekti, në përgjigjet e pyetësorit standard, ka deklaruar shpenzimet si: linjë elektrike, blerje transformatori, shtrim rrjeti, kontratë me OSHEE-në, mbjellje e kulturave dru-frutore, pleh, bletari, tubacion e depozita uji, kabinë roje, blerje farash dhe pulash, gardhe, mure rrethues, punëtori, etj., në pronën M, Tiranë. Në total, shpenzimet sipas pjesës takuese janë në shumën 1.160.000 lekë.

Gjithashtu edhe në DPV-në (deklaratë periodike vjetore) e vitit 2016 janë deklaruar shpenzimet e mësipërme.

Subjekti i rivlerësimit u pyet⁷ nga Komisioni në lidhje me investime shtesë të kryera në pasurinë ullishte nga viti 2016 e në vijim. Në përgjigje, subjekti ka deklaruar se në këtë pasuri, në DPV-në e vitit 2019 ka deklaruar shpenzime vjetore për mirëmbajtje trualli rreth 550.000 lekë, si dhe shpenzime të tjera për farëra, fidane, ujitje, krasitje, etj.

⁷ Me pyetësorin e datës 21.7.2020.

Në përgjigje të kërkesës së Komisionit, subjekti⁸ ka depozituar foto në momentin e blerjes së kësaj pasurie dhe foto pas blerjes së saj. Në foto evidentohen investimet e natyrës bujqësore dhe të mirëmbajtjes së pasurisë. Nga fotot duket se ka një mirëmbajtje të kësaj pasurie dhe kultivim të produkteve bujqësore fruta/perime në mënyrë modeste, për konsum të përditshëm familjar.

Komisioni ka hetuar në lidhje me konfliktin e interesit që mund të kishte subjekti me shitësin e kësaj pasurie, z. E. A, dhe me bashkëpronarin aktual të kësaj pasurie, z. M. M. Për këtë shkak subjekti është pyetur nëse ka pasur çështje në hetim, të regjistruara ndaj tyre, që nga momenti që ka ushtruar detyrën e prokurores.

Subjekti ka deklaruar⁹ se nuk ka pasur asnjë çështje në hetim apo të regjistruar ndaj personave të sipërpërmendur dhe në mbështetje të shpjegimeve të saj ka depozituar:

- shkresë nr. **** prot., datë 11.9.2020, lëshuar nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Krujë;
- shkresë nr. **** prot., datë 11.9.2020, lëshuar nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë;
- shkresë nr. *** prot., datë 11.9.2020, lëshuar nga Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar.

Të tria këto institucione konfirmojnë se gjatë periudhës së ushtrimit të funksionit të prokurores, znj. Pranvera Pustina nuk ka pasur çështje në hetim/të regjistruara ndaj shtetasve M.M, E. A dhe me shoqërinë “T. P” sh.p.k. Komisioni, gjithashtu ka hetuar në lidhje me çmimin e blerjes, ku referuar VKM-së nr. 89/2016 “Për miratimin e vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë” në fshatin Mumajes me z. k. ***, vlera e tokës është 470 lekë/m². Bashkëshorti i subjektit e ka blerë këtë tokë në shumën 853 lekë/m² dhe krahasuar me çmimin sipas VKM-së, duket se kjo pasuri është blerë me çmim më të lartë nga çmimi i referencës.

1.5 Analiza financiare

Komisioni kreu analizën financiare për te vlerësuar mundësinë financiare për blerjen e pasurisë me burime të ligjshme, nga ku ka rezultuar se subjekti dhe bashkëshorti kanë pasur burime të ligjshme, të mjaftueshme për të blerë pronën, si dhe për të përballuar shpenzimet e tjera.

1.6 Në konkluzion, trupi gjykues, në analizë të deklarimeve të subjektit në deklaratën *Vetting* dhe në deklaratat periodike, pasi shqyrtoi dhe analizoi provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit dhe ato të administruara gjatë hetimit, konstaton se subjekti ka deklaruar me vërtetësi dhe saktësi, në përputhje me nenin D të Aneksit të Kushtetutës, ekzistencën e kësaj pasurie, mënyrën e fitimit dhe burimin e krijimit të saj, si dhe ka burime financiare të ligjshme për krijimin e kësaj pasurie.

2. Apartament me sipërfaqe 107.4 m², blerë nga bashkëshorti në vitin 2016, në Qerret, Kavajë, në proces legalizimi, fshati A. H.

Vlera e deklaruar: 69.000 euro.

Pjesa në përqindje: 50 % pjesa takuese.

Burimi i krijimit: të ardhurat e tatueshme nga llogaritë rrjedhëse.

Deklarimi në DPV: të ardhurat e tatueshme nga bashkëshorti.

⁸ Në përgjigjet e pyetësorit të datës 14.9.2020.

⁹ Në përgjigjet e pyetësorit të datës 14.9.2020.

Mënyra e fitimit: nëpërmjet kontratës noteriale nr. *** rep., **** kol., datë 1.11.2016, për transferimin e të drejtave.

2.1 Faktet e rezultuara nga hetimi administrativ

ZVRPP-ja¹⁰ Kavajë nuk e ka konfirmuar këtë pasuri të regjistruar në emër të personit të lidhur.

ALUIZNI¹¹- Drejtoria e Përgjithshme ka informuar se shtetasi F. F. P ka rezultuar i pajisur me leje legalizimi nr. ****, datë 13.12.2018, kontratë shitje nr. **** rep., nr. *** kol., datë 11.12.2018, për kalimin e të drejtës së pronësisë së truallit banim zona e stimuluar “A.H” Golem Kavajë.

ALUIZNI – Zonat Turistike¹² ka informuar se pranë kësaj drejtorie është administruar praktika nr. *** prot., datë 22.4.2015, në emër të subjektit vetëdeklarues F.F.P, për të cilin është lëshuar leja e legalizimit nr. **, datë 13.12.2018.

Referuar dokumentacionit të dosjes hetimore ka rezultuar leje legalizimi nr. ****, datë 13.12.2018, për objekt banimi, në emër të z. F. P, me adresë: zona e stimuluar “A. H” Golem, Kavajë. Titulli i pronësisë mbi tokën, vërtetuar me dokumentin “kontratë shitje nr. **** rep., nr. *** kol., për kalimin e të drejtës së pronësisë së truallit datë 11.12.2018”.

Komisioni ka hetuar në lidhje me çmimin e blerjes së kësaj prone dhe referuar Udhëzimit nr. 3, datë 28.12.2016, të Këshillit të Ministrave, çmimi i referencës për banesat në Kavajë është 51.000 lekë, nga ku duket se subjekti e ka blerë këtë pasuri me çmim më të lartë se ai i EKB-së, faktikisht 86.900 lekë/m².

Në dokumentacionin e depozituar nga ALUIZNI – Zonat Turistike, ndodhet një kontratë shitjeje nr. *** rep., nr. *** kol., datë 11.12.2018, për kalimin e të drejtës së pronësisë së truallit, nënshkruar ndërmjet z. F.P, në cilësinë e blerësit dhe ALUIZNI – Zonat Turistike, në cilësinë e shitësit, i cili ble truall me sip. 163.89 m², në çmimin 377.603 lekë (vlera e truallit të njësisë së ndërtuar), 4.917 lekë (vlera e tarifës së përditësimit të pronës).

Në nenin 4 të kontratës është parashikuar: “Me lidhjen e kësaj kontrate shitësi i kalon blerësit, në pronësi sipërfaqen e pasurisë së paluajtshme, të përcaktuar në nenin 2, të kësaj kontrate, të lirë nga çdo barrë apo detyrim tatimor”. Bashkëlidhur kontratës janë mandatpagesa në shumën përkatëse nga z. F. P.

2.2 Burimi i krijimit

Subjekti ka deklaruar se kjo është pasuri e blerë me të ardhurat e bashkëshortit. Në deklaratën Vetting, z. F.P ka deklaruar kontratën për transferim të drejtash (apartament i paregjistruar, në proces legalizimi nga pronari aktual), me burim të ardhurat e tatueshme nga llogaritë rrjedhëse. Transaksion tërësisht bankar. Kësti i parë në vlerën 34.000 euro, paguar më 9.11.2016, nëpërmjet transaksionit bankar. Pjesa takuese: 100 % në pronësi.

2.3 Analiza e fakteve

Ndërmjet bashkëshortit të subjektit, z. F. P, dhe z. J. G. E. R është lidhur kontrata nr. ****/rep/kol., datë 1.11.2016, për transferim të drejtash, ku shtetasi i dytë transferon të drejtat pronësore dhe zotërimin mbi pasurinë “vilë” ose 1/3 e saj si pjesë fizike e ndarë dhe oborrin e përbërë me sip. rreth 400 m², sipas planimetrisë në shtojcën bashkëlidhur kontratës.

¹⁰ Me shkresën nr. *** prot., datë 13.2.2019.

¹¹ Me shkresën nr. ***prot., datë 14.2.2019.

¹² Me shkresën nr. **** prot., datë 20.2.2019.

Transferimi i të drejtave pronësore dhe posedimore, duke përfshirë edhe pjesën takuese të oborrit kryhet kundrejt çmimit prej 69.000 euro.

Në lidhje me çmimin që do të paguhej për këtë pasuri, në kontratë, në nenin 2 është parashikuar: *“... pjesa e parë e çmimit prej 34.000 euro do të paguhet nga blerësi te shitësi brenda muajit nëntor 2016; pjesa e mbetur e çmimit prej 35.000 euro do t’i paguhet shitësit nga blerësi brenda muajit maj 2018, në disa këste apo në një kësht të vetëm. Duke pasur parasysh që fshati turistik dhe pasuria, si pjesë e fshatit turistik është në proces legalizimi, palët bien dakord që blerësi të zëvendësojë shitësin në procedurën e legalizimit për pasurinë, duke përfshirë në të edhe tokën nën b/pronësi dhe oborrin”.*

Në dosje ka rezultuar kopje e njëhësuar me origjinalin e vendimit të datës 8.10.2010, të asamblesë së ortakëve të shoqërisë “A. H” sh.p.k., e cila ka qenë shoqëria ndërtuese e kësaj pasurie. Sipas këtij vendimi, pasuritë e ndërtuara nga kjo shoqëri në Q, Golem- Kavajë, janë ndarë ndërmjet 2 ortakëve të saj, shitësit të kësaj pasurie dhe një personi tjetër. Pasuria që deklaroi subjekti i takonte shitësit J.G. E. R.

Në dosje ka rezultuar gjithashtu dhe një urdhërpagese datë 9.11.2016, në shumën 34.000 euro në BKT, me përfitues z. J. G. E. R dhe urdhërues z. F. P.

Subjekti ka depozituar në Komision nxjerrje të llogarisë bankare në emër të bashkëshortit, në BKT-në Kosovë. Nga verifikimi i kryer ka rezultuar se nga llogaria e z. F.P është transferuar shuma prej 34.000 euro sipas kontratës për transferim të drejtash.

Në lidhje me pagesën e kështit të dytë për blerjen e kësaj shtëpie, subjekti ka shpjeguar¹³ se: *“Është paguar vetëm kështi i parë i çmimit të kontratës në shumën prej EUR 34,000, i deklaruar në mënyrë të rregullt. Kështi i dytë, i papaguar dhe do të deklarohet në momentin e pagesës. Burimi i të ardhurave për kështin e paguar në shumën prej EUR 34,000 janë të ardhurat e ligjshme dhe të tatuara të F. P. Pagesa është bërë nëpërmjet transfertës bankare dhe është e evidentueshme dhe me përshkrimin përkatës”.*

Komisioni ka hetuar nëse subjekti ka pasur çështje në hetim/të regjistruara në ngarkim të shtetasit J. G. E. R, por subjekti ka shpjeguar¹⁴ se nuk ka pasur asnjë çështje në hetim apo të regjistruar ndaj këtij shtetasi.

Në mbështetje të shpjegimeve të saj, subjekti ka depozituar:

- shkresë nr. **** prot., datë 11.9.2020, lëshuar nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë; dhe
- shkresë nr. *** prot., datë 11.9.2020, lëshuar nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Krujë.

Të dyja këto institucione konfirmojnë se gjatë periudhës së ushtrimit të funksionit të prokurores, znj. Pranvera Pustina nuk ka pasur çështje në hetim/të regjistruara ndaj shtetasit J. G. E. R.

2.4 Analiza financiare

2.4.1 Komisioni ka kryer një analizë financiare mbi mundësinë e blerjes së pasurisë, sipas së cilës ka rezultuar se subjekti dhe bashkëshorti kanë pasur burime të ligjshme, të mjaftueshme për të blerë pronën, si dhe për të përballuar shpenzimet e tjera.

¹³ Në përgjigjet e pyetësorit të datës 13.5.2020.

¹⁴ Në përgjigjet e pyetësorit të datës 14.9.2020.

Nga verifikimi i llogarive bankare evidentohet fakti se fondi ka kaluar me transfertë bankare nga llogaria e z. F. P, pranë BKT-së Kosovë, në datën 10.11.2016.

2.4.2 Në konkluzion, trupi gjykues, në analizë të deklaramëve të subjektit në deklaratën *Vetting* dhe në deklaratat periodike, pasi shqyrtoi dhe analizoi provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit dhe ato të administruara gjatë hetimit, konstaton se subjekti ka deklaruar me vërtetësi dhe saktësi, në përputhje me nenin D të Aneksit të Kushtetutës, ekzistencën e kësaj pasurie, mënyrën e fitimit dhe burimin e krijimit të saj, si dhe ka burime financiare të ligjshme për krijimin e kësaj pasurie.

2.4.3 Komisioni evidentoi faktin se subjekti duhet të kishte deklaruar në rubrikën e detyrimeve pagesën e kësaj të dytë, si të papaguar ende, duke e vlerësuar si një pasaktësi në deklaram, detyrimin e padeklaruar.

3. Automjet¹⁵ tip “BMW X5”, blerë në vitin 2015, me targa AA * ME**

Vlera e deklaruar: 23.000 euro.

Pjesa në përqindje: 50 % e pjesës takuese të bashkëshortit.

Burimi i krijimit: të ardhurat e tatueshme nga llogaritë rrjedhëse.

3.1 Faktet e rezultuara nga hetimi administrativ

DPSHTRr-ja¹⁶ ka konfirmuar automjetin me targa AA *** ME, në emër të z. F .P, duke bashkëlidhur fotokopje të njehsuara me origjinalin të dokumentacionit të fitimit të pronësisë mbi automjetin, faturën e shitblerjes së automjetit tip “BMW” nga shoqëria “L. GMBH” te z. F.P në shumën 23.500 euro, datë 27.7.2015 dhe autentifikim nënshkrimi nr. ****, datë 29.7.2015.

Në dosjen e ILDKPKI-së ka rezultuar një dokument në gjuhën gjermane, ku figuron nënshkrues z. F.P me subjektin “L GMBH”, në të cilin referohet një shumë prej 23.500 euro, datë 27.7.2015. Në dosje ka rezultuar gjithashtu:

- mandatpagesë nga BKT-ja për shumën e paguar 23.500 euro, më 24.7.2015; si dhe
- deklarata e zhdoganimit për shumën e blerjes sipas kontratës me vlerë zhdoganimi 667.829 lekë.

3.2 Burimi i krijimit

Bashkëshorti i subjektit deklaroi se e ka në pronësi 100 % këtë pasuri, blerë me të ardhurat personale të tatueshme. Pjesa e kryer tërësisht me transfertë bankare.

Komisioni ka hetuar në lidhje me automjetet në përdorim nga subjekti i rivlerësimit, nga momenti që ka filluar ushtrimin e detyrës së prokurorit e në vijim.

Subjekti ka shpjeguar¹⁷ se që nga viti 2015 ka përdorur bashkërisht me bashkëshortin (sipas nevojave të familjes) automjetin në pronësi të tij me targa AA ***ME. Nga viti 2013 deri në vitin 2016 ka përdorur bashkërisht me bashkëshortin (sipas nevojave të familjes) automjetin

¹⁵ Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës: Aneksi 4/4,

- certifikata e pronësisë së automjetit me targa AA *** ME, në emër të z. F. P;
- dokument në gjuhën gjermane me BMW nga L te z. F. P referohet një shumë 23.500 euro, datë 27.7.2015. Nuk jam në gjendje të them që është kontrata;
- konfirmë bankare nga BKT-ja për shumën e paguar 23.500 euro, më 24.7.2015;
- deklarata e zhdoganimit për shumën e blerjes sipas kontratës me vlerë zhdoganimi 667.829 lekë.

Konfirmë bankare nga BKT-ja, datë 29.7.2015, për shumën e derdhur 667.829 lekë, plus kërkesë për transaksion në këtë shumë.

¹⁶ Me shkresën nr. *** prot., datë 16.10.2019.

¹⁷ Me përgjigjet e pyetësorit të datës 09.09.2020

në pronësinë e saj, blerë nga bashkëshorti F.P, nr. shasio W****, në atë kohë targar AA *** HT, deklaruar në mënyrë të rregullt nga subjekti.

Bashkëlidhur përgjigjeve të pyetësorit, subjekti ka depozituar një vërtetim, lëshuar nga DPSHTRr-ja, i cili provon automjetin e vetëm në pronësinë e subjektit, të regjistruar pranë këtij institucioni.

Nga verifikimi i të dhënave *online* në sistemin e AMF-së ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit, bazuar në një policë sigurimi, lëshuar për një automjet të tipit “R” vit prodhimi 2000, ka qenë me status përdorues. Polica e sigurimit është lëshuar për periudhën 18.9.2009 – 17.9.2010.

✓ Deklarimi i subjektit përputhet me dokumentacionin e depozituar dhe me të dhënat e ardhura nga DPSHTRr-ja.

3.3 Analiza financiare

Nga verifikimi i llogarive bankare ka rezultuar se fondi për blerjen e automjetit ka kaluar me transfertë në datën 24.7.2015, nga llogaria në euro, në BKT, e z. F.P, te shitësi.

Komisioni ka analizuar mbi mundësinë e blerjes së pasurisë, ku ka rezultuar se subjekti dhe bashkëshorti kanë pasur burime të ligjshme, të mjaftueshme për të blerë automjetin.

3.4 Në konkluzion, trupi gjykues, në analizë të deklarimeve të subjektit në deklaratën *Vetting* dhe në deklaratat periodike, pasi shqyrtoi dhe analizoi provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit dhe ato të administruara gjatë hetimit, konstaton se subjekti ka deklaruar me vërtetësi dhe saktësi, në përputhje me nenin D të Aneksit të Kushtetutës, ekzistencën e kësaj pasurie, mënyrën e fitimit, burimin e krijimit të saj, si dhe ka burime financiare të ligjshme për krijimin e kësaj pasurie.

4. Aksione në 20 % të kapitalit¹⁸ të shoqërisë “C.J.E” sh.p.k., e barabartë me 1 kuotë/pjesë kapitali të nënshkruar të shoqërisë, regjistruar në datën 12.11.2015

Pjesa në përqindje: 50 % e pjesës takuese të bashkëshortit, i cili zotëron 20 % të kapitalit.

Mënyra e fitimit: nëpërmjet statutit të shoqërisë dhe regjistrimit të tyre në QKB.

4.1 Faktet e rezultuara nga hetimi administrativ

QKB-ja¹⁹ ka informuar se z. F.P figuron ortak zotëruar i 20 % të kuotave në shoqërinë “C. J.E” sh.p.k., me NIPT L****P, regjistruar në datën 12.11.2015.

Nga verifikimi në sistemin *online* të QKB-së ka rezultuar se kjo shoqëri është me status aktiv me objekt veprimarie “organizimi dhe zhvillimi i aktiviteteve kulturore dhe artistike në tërësi, etj”.

DRT-ja Tiranë²⁰ konfirmon se shtetasi F.P është ortak me 20 % të kuotave të shoqërisë “C. J. E” sh.p.k., me NIPT L***P. Aktivitete mbështetëse për shfaqje artistike.

¹⁸ Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës: Aneksi 4/5,

- ekstrakt i regjistrimit tregtar për regjistrim në QKB, datë 12.11.2015 të subjektit “C. J.E” sh.p.k., me datë themelimi 9.11.2015; kapital 200.000 lekë; objekt aktiviteti “organizimi dhe zhvillimi i aktiviteteve kulturore dhe artistike në tërësi, etj.”, me administrator z. R.B, ku ortaku F. P figuron me 20 % të kuotave ose 40.000 lekë. Printim i datës 24.1.2017;

- certifikatë regjistrimi në QKB e personit të tatueshëm “C.J.E” sh.p.k. me afat veprimtarie prej datës 9.11.2015; data e lëshimit 12.11.2015;

- statut i shoqërisë “C. J. E” sh.p.k., datë 9.11.2015;

- QKB-ja, me shkresën nr. ***a, datë 24.7.2017, konfirmon se shtetasi F. P figuron si ortak, zotëruar i 20 % të kuotave në shoqërinë “C.J.E” sh.p.k., regjistruar në QKB me NIPT L****P. Bashkëlidhur shkresës ekstrakti historik. Aneksi 31.

¹⁹ Me shkresën nr. **** prot., datë 25.2.2019.

²⁰ Me shkresën nr. *** prot., datë 28.8.2017.

Referuar dokumentacionit zyrtar të administruar në dosje (sipas bilanceve për vitet 2015-2016), duket se nuk janë gjeneruar të ardhura nga ky aktivitet.

✓ Nga hetimi i kryer deklarimi i subjektit përputhet me dokumentacionin e dorëzuar dhe me përgjigjet e ardhura QKB-ja dhe DRT-ja Tiranë.

5. Aksione në 40 % të vlerës së kapitalit²¹ të shoqërisë “G.* sh.p.k., me NIPT K**T, blerë në vitin 2014**

Vlera e deklaruar: pjesëmarrja në kapital e barabartë në shumën 1.128.000 lekë.

Pjesa në përqindje: 50 % e pjesës takuese të bashkëshortit, i cili zotëron 40 % të kapitalit të shoqërisë.

Mënyra e fitimit: nëpërmjet kontratave të shitblerjes së kuotave të z. F. P me 2 shitësit me pjesë 40 % të kapitalit të shoqërisë, të datave 7.2.2014 dhe 27.1.2014.

5.1 Faktet e rezultuara nga hetimi administrativ

QKB-ja²² ka konfirmuar se shtetasi F.P figuron të ketë qenë ortak, zotërues i 40 % të kuotave në shoqërinë “G. *” sh.p.k. regjistruar në QKB me NIPT K****T. Ky shtetas është larguar më 21.09.2018. Bashkëlidhur shkresës, ekstrakti historik.

Bashkia Tiranë²³ ka konfirmuar se shtetasi F. P është i regjistruar me NIPT K****T për aktivitetin “pub” në adresën: Rr. “D. H”, p. Gener 2, me status aktiv, me datë licensimi 5.11.2013. Nga analizimi i dokumentacionit të administruar, referuar bilaneve të depozituar në QKB, ka rezultuar se ky aktivitet ka qenë me humbje për vitet 2014, 2015 dhe 2016.

✓ Sa më sipër, deklarimi i subjektit përputhet me dokumentacionin e dorëzuar dhe me përgjigjen e ardhur nga QKB-ja dhe Bashkia Tiranë.

Llogari bankare në emër të subjektit Pranvera Pustina, si vijojnë:

6. Llogari kursimi²⁴ në euro, shuma 5.932 euro në BKT, çelur më 5.10.2016.

6.1 Burimi i krijimit

subjekti ka shpjeguar se në këtë llogari është depozituar shuma e çmimit të shitjes prej 6.300 euro, të autoveturës tip “BMW”, me targa AA *** HT, sipas kontratës noteriale të shitjes. Gjithashtu, në këtë llogari bankare janë depozituar shumat prej 35 euro në formën e rimbursimit lidhur me një aktivitet trajnues zhvilluar nga OSCE-ja dhe shuma 881.39 euro nga E.C, rimbursim lidhur me një aktivitet trajnues.

6.2 Faktet e rezultuara nga hetimi administrativ

²¹ Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës: Aneks 4/6

- ekstrakt i regjistrit tregtar për regjistrim në QKB, datë 21.10.2007 të subjektit “G.*” sh.p.k., me datë themelimi 1.10.2007; kapital 2.820.000 lekë; objekt aktiviteti “klub, pub, klub nate (diskotekë), ambiente për muzikë *live*, import eksport të mallrave të ndryshme kryesisht ushqimore dhe të natyrës së shërbimit të mësipërm” ; administrator E, D ku ortaku F. P figuron me 40 % të kuotave ose 1.128.000 lekë. Printim i datës 26.1.2017;

- kontratë për shitblerjen e kuotave datë 27.1.2014, ku z. F. P ble nga z. Q. Gj 564 kuota, të cilat përfaqësojnë 20 % të kuotave të kapitalit të shoqërisë “G. *” sh.p.k. në vlerën 564.000 lekë;

- kontratë për shitblerjen e kuotave datë 7.2.2014, ku z. F. P ble nga z. Q. Gj 564 kuota, të cilat përfaqësojnë 20 % të kuotave të kapitalit të shoqërisë “G. *” sh.p.k. në vlerën 564.000 lekë;

- autorizim datë 30.1.2013, lëshuar nga administratori E. D për depozitimin në QKB të dokumentacionit të shoqërisë “G *” sh.p.k.

²² Me shkresën nr. *** prot., datë 25.2.2019.

²³ Me shkresën nr. ***a, datë 24.7.2017, drejtuar ILDKPKI-së.

²⁴ Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës *statement* nga BKT-ja, datë 10.1.2017, për gjendjen e llogarisë datë 30.12.2016, në shumën 5.931 euro. Figurojnë *cash* depozitë datë 9.9.2016, nga z. I. M shuma 6.300 euro për blerje e automjetit tip “BMW”, me targa AA *** HT sipas kontratës së shitblerjes; 35 euro nga OSCE-ja Beograd; 881.39 euro nga E.C.

“Banka Kombëtare Tregtare” sh.a.,²⁵ ka konfirmuar gjendjen e llogarisë në shumën 5.932 euro.

Nga verifikimi i akteve të administruara nga Komisioni, ka rezultuar një kontratë shitblerjeje automjeti me nr. *** rep., nr. *** kol., datë 7.9.2016, ndërmjet subjektit dhe z. I.M, për automjetin me targa AA *** HT, në çmimin 6.300 euro. Sipas kontratës kjo shumë do të paguhej në llogarinë bankare të shitësit.

Bashkëlidhur kontratës ka rezultuar edhe një mandatpagesë e BKT-së, sipas së cilës z. I. M, me cilësinë e blerësit ka depozituar shumën prej 6.300 euro, pagesë për blerjen e automjetit tip “BMW”, me targa AA *** HT, në llogarinë e znj. Pranvera R. Hoxha.

Komisioni ka hetuar nëse subjekti ka pasur çështje në hetim apo në ngarkim të shtetasit I. M gjatë kohës së ushtrimit të detyrës. Subjekti shpjegoi²⁶ se nuk ka pasur asnjë çështje në hetim apo të regjistruar ndaj këtij shtetasi.

Në mbështetje të shpjegimeve të saj, subjekti ka depozituar:

- shkresë nr. *** prot., datë 11.9.2020, lëshuar nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Krujë;
- shkresë nr. **** prot., datë 11.9.2020, lëshuar nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë;
- shkresë nr. *** prot., datë 11.9.2020, lëshuar nga Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar Tiranë.

Të tria insitucionet e mësipërme konfirmuan se gjatë periudhës së ushtrimit të funksionit të prokurores, znj. Pranvera Pustina nuk ka pasur çështje në hetim/të regjistruara ndaj shtetasit I. M.

6.3 Në konkluzion, trupi gjykues, në analizë të deklarimeve të subjektit në deklaratën *Vetting*, dhe në deklaratat periodike, pasi shqyrtoi dhe analizoi provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit dhe ato të administruara gjatë hetimit, konstaton se subjekti ka deklaruar me vërtetësi dhe saktësi, në përputhje me nenin D të Aneksit të Kushtetutës, ekzistencën e kësaj pasurie, mënyrën e fitimit, burimin e krijimit të saj, si dhe ka deklaruar saktë shumën që ka buruar nga shitja e këtij automjeti dhe në përputhje me ligjin.

7. Llogari ²⁷në BKT:

- llogari kursimi me nr. ****, hapur më 27.10.2015, e krijuar nga kursimet e pagës së subjektit si prokurore duke filluar nga data 6.10.2014. Shuma në momentin e deklarimit 452.383 lekë;
- llogari page me nr. ****, në shumën 1.061 lekë, ku derdhet paga mujore në “Credins Bank”.

BKT-ja²⁸ ka konfirmuar gjendjen e llogarisë më 27.1.2017, në shumën 1.313.4 lekë.

✓ Deklarimi i subjektit përputhet me përgjigjen e ardhur nga BKT-ja.

Deklarimi i pasurive të bashkëshortit, z. F. P

Bashkëshorti i subjektit ka deklaruar se zotëron pasuri të regjistruara veçmas, si vijon:

8. Apartament²⁹ në rezidencën “K.D”, Selitë, Farkë

²⁵ Me shkresën nr. *** prot., datë 26.2.2019.

²⁶ Në përgjigjet e pyetësorit të datës 14.9.2020.

²⁷ Subjekti, për të dyja këto llogari, ka bashkëlidhur deklaratën *statement* të llogarisë nga BKT-ja, të datës 10.1.2017:

- për gjendjen e llogarisë në datën 1.1.2017, në shumën 452.383 lekë;
- 2017 për gjendjen e llogarisë në vlerën 1.463 lekë, datë 28.12.2016.

²⁸ Me shkresën *** prot., datë 26.2.2019.

²⁹Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës:

Vlera e deklaruar: 53.940 euro;

Pjesa në përqindje: 100 % në pronësi të b/shortit të subjektit. Pasuri e blerë para martese.

Burimi i krijimit: kredi në shumën 52.122 euro në “*****”. Shlyer tërësisht para afatit të përfundimit të kredisë. Shuma e mbetur e principalit prej 38.565 euro dhe pagesë penalteti për shlyrje të parakohshme prej 1.207 euro, paguar më 11.9.2013.

Deklarimi në DPV: kredi në shumën 52.122 euro, në “*****”.

Mënyra e fitimit: blerë me kontratën noteriale nr. *****/rep/kol., më 24.5.2005.

8.1 Faktet e rezultuara nga hetimi administrativ

ZVRPP-ja Tiranë³⁰ ka konfirmuar pasurinë apartament me sip. 210.765 m² e regjistruar në emër të z. F.P. Për këtë pasuri janë administruar: kartela e pasurisë dhe kontrata e shitblerjes nr. *****/rep/kol., datë 24.6.2005, ku z. F. P ka blerë nga shoqëria “A.K” sh.p.k., apartamentin me sip. totale 210.765 m², në vlerën 53.940 euro.

UKT-ja³¹ ka informuar se në emër të z. F. F. P, identifikohet një abonent me kontratë me nr. ***, me vendndodhje “Rr. U” K. D, Tiranë. Kontrata është me status aktiv në kategorinë e konsumatorëve familjarë.

OSHEE-ja³² nuk ka konfirmuar kontratë të lidhur për këtë pasuri në emër të personit të lidhur.

Në lidhje me këtë pasuri, subjekti ka shpjeguar³³ se ka filluar të banojë në apartamentin në pronësi të bashkëshortit në K. D, në momentin e lidhjes së martesës rreth muajit maj të vitit 2012.

8.2 Analiza e fakteve

Nga aktet e depozituar nga subjekti ka rezultuar se ndërmjet bashkëshortit të subjektit, z. F. P, dhe shoqërisë “A.K” sh.p.k., është nënshkruar një kontratë shitblerjeje nr.*****/rep/kol., datë 24.6.2005, ku z. F. P ble nga kjo shoqëri apartamentin me sip. 210 m², në vlerën 53.940 euro. Në lidhje me pagesën në kontratë është parashikuar se vlera 3.940 euro do të paguhej me nënshkrimin e kontratës dhe pjesa tjetër 50.000 euro do të paguhet me *disbursimin* e kredisë nga Banka Amerikane e Shqipërisë. Në momentin e nënshkrimit të kontratës, ndërtimi i apartamentit kishte përfunduar.

Palët e mësipërme, përpara nënshkrimit të kontratës së shitblerjes me nr.*****/rep/kol., datë 24.6.2005, kishin nënshkruar një kontratë sipërmarrjeje në datën 24.5.2005, ku pala porositëse

-
- kontratë shitblerje nr.*****/rep/kol., datë 24.6.2005, ku z. F.P ble nga shoqëria “A.K” sh.p.k. apartamentin me sip. totale 210. 765 m², në vlerën 53.940 euro;
 - kontratë sipërmarrje datë 24.5.2005, ku pala porositëse F. P, porositi te pala sipërmarrëse apartamentin në S me sip. totale 210.8 m², në shumën 86.430 euro;
 - certifikatë për vërtetim pronësie datë 18.2.2005 për apartament me sip. 210.765 m², në emër të shoqërisë “A. K” sh.p.k., plus kartelë pasurie, hartë treguese e regjistrimit;
 - kontratë hipotekimi nr. ***/rep/kol., datë 29.6.2005 për vendosjen në hipotekë në favor të Bankës Amerikane të pasurisë apartament me sip. 210.8 m² me qëllim garantimin e kredisë nr.*****/rep/kol., datë 29.6.2005, në shumën 50.000 euro;
 - kontratë kredie bankare nr. *****/rep/kol., datë 29.6.2005, në shumën 50.000 euro për blerjen e një apartamenti.
 - amendament nr. *****/rep/kol., datë 11. 7.2007, i kontratës së kredisë bankare nr. *****/rep/kol., datë 29.6.2005 për ofrimin e kredisë në shumën 2.121 euro;
 - amendament nr. ***/rep/kol., datë 19.5.2008, i kontratës së kredisë bankare nr. *****/rep/kol., datë 29.6.2005 për ndryshimin e interesit të kredisë në +3.5 %.
 - kartelë pasurie për apartament me sip. 210.765 m² në emër të z. F. P, ku shuma e paguar është 53.940 euro.

³⁰ Me shkresën nr. *** prot., datë 20.2.2019.

³¹ Me shkresën nr. *** prot., datë 13.2.2019.

³² Me shkresën nr. **** prot., datë 21.2.2019.

³³ Në përgjigje të pyetësorit të datës 14.9.2020.

F. P, porositi te pala sipërmarrëse apartamentin në Selitë me sip. totale 210.8 m². Sipas kontratës së sipërmarrjes ka rezultuar se çmimi i sipërmarrjes së apartamentit ishte në shumën 86.430 euro. Pagesat do të jenë: 14.000 euro do të likuidohen me nënshkrimin e kontratës; 9.000 euro do të likuidohen më 23.5.2005; 50.000 euro me *disbursimin* e kredisë, datë 25.5.2005 dhe 13.430 euro do likuidohen brenda janarit të vitit 2006. Pagesat do të kryhen nga porositësi dhe do të vërtetohen me mandatarëkëtimet e lëshuar nga shoqëria. Më tej, palët kanë parashikuar në kontratë që në rast mospagimi në kohë të kësteve nga porositësi, ky i fundit do t'i paguante sipërmarrësit një kamatëvonesë prej 2.000 USD, për vonesë deri në 30 ditë.

8.2.1 Nga analizimi i kontratave të sipërmarrjes dhe kontratës së shitblerjes u evidentua mospërputhje lidhur me çmimin e blerjes së pasurisë apartament

Në lidhje me mospërputhjen e çmimit të apartamentit, në dy aktet e nënshkruar nga personi i lidhur për këtë pasuri, subjekti u pyet, e cila ka dhënë shpjegimet si vijon³⁴: *“Pasuria së cilës i referoheni është pasuri e fituar nga bashkëshorti F.P, 7 vite përpara martesës, duke shpjeguar se bashkëshorti gjatë vitit 2004 apo mbase pak më herët, ka diskutuar me shoqërinë ‘A.K’ për blerjen e një apartamenti në katin e fundit të ndërtesës së parë (nën ndërtim), në bllokun që sot njihet si Rezidenca K D, fillimisht me sipërfaqe rreth 95 m² sipërfaqe banimi dhe rreth 27-30 m² verandë dhe më pas me modifikimin e projektit, plus rreth 55 m² shtesë papafingo/nënçati dhe 1 verandë e dytë në nënçati (tarracë) rreth 25-30 m². Përfituesi fundor i shoqërisë ‘A. K’ dhe përfaqësuesi i saj ligjor, në atë kohë, ishte dhe është një nga miqtë personal të bashkëshortit. Kontrata e sipërmarrjes për projektin e modifikuar (ku përfshihej nënçatit) u firmos më 24.5.2005, me çmimin 86,430 euro dhe sipërmarrësi parashikonte në atë kohë përfundimin e ndërtimit dhe dorëzimin në një kohë relativisht të shpejtë dhe optimiste, në fillim të vitit 2006, kohë në të cilën parashikohej edhe pagesa e këstit të fundit të çmimit në kontratën e sipërmarrjes. Pagesa e çmimit shpërndahej në 4 këste të ndryshme dhe transferimi i titullit të pronësisë bëhej pas pagesës së këstit të fundit dhe kontratës përfundimtare të shitblerjes. Blerja në atë kohë ishte parashikuar të financohej në pjesën e saj më të madhe nga American Bank of Albania (‘ABA’), e cila pavarësisht marrëdhënies preferenciale me institucionin ku punonte bashkëshorti (fondacioni ‘Shoqëria e Hapur për Shqipërinë’) kishte kërkuar ndër të tjera që financimi i kredisë të garantohej nga një kolateral/hipotekë në pronësi e blerësit, aset të cilin në atë kohë bashkëshorti nuk e dispononte dhe që me bankën po negociohej që vetë apartamenti në zhvillim e sipër, të vendosej kolateral pasi të kalonte në pronësinë e blerësit. Shuma e kërkuar e kredisë në atë kohë ishte menduar të ishte eur 50,000 dhe kjo ishte shuma maksimale që ABA ofronte vetëm për klientë preferencialë individë.*

Në qershor 2005, për shkak të konceptimit të projektit të rezidencës së mbyllur nga zhvilluesi (sot rezidenca K. Dt) dhe nisjes së punimeve në disa blloqe të tjera apartamentesh njëkohësisht, nga zhvilluesi u kërkuar të negociohej amendimi i marrëveshjes së sipërmarrjes, dhe shtyrja e afatit të përfundimit të ndërtimit të apartamentit dhe bllokut nën ndërtim, në një datë më realiste, të paktën deri në fund të vitit 2007, por jo më vonë se viti 2009, që do të përkonte edhe me finalizimin e bllokut të parë të rezidencës dhe sistemimin e rrugëve të brendshme. Një shtyrje e tillë do të sillte njëkohësisht edhe shtyrjen e kësteve të pagesave, por mbi të gjitha tashmë do të bënte që titulli i pronësisë të transferohej te blerësi pas të paktën 2-3 vjetësh (pas pagesës së këstit të fundit) dhe kjo e bënte të pamundur garantimin e financimit potencial të bankës me kolateral dhe, si pasojë, rrezikonte marrjen e financimit. Në atë kohë apartamenti sapo ishte përfunduar në karabina dhe suvatime të brendshme dhe ishte regjistruar pak javë më parë pranë ZVRPP-së Tiranë, në emër të shoqërisë zhvilluese.

³⁴ Në përgjigjet e pyetësorit të datës 13.5.2020.

*Për këtë arsye, pas bisedave me shoqërinë zhvilluese dhe bankën, u ra dakord që apartamenti të shitej menjëherë dhe vetëm një muaj pas firmosjes së sipërmarrjes, tashmë nëpërmjet një kontrate shitblerjeje finale (kontrata nr. *** rep., nr. *** kol), në gjendjen 'siç është' (i papërfunduar) me një çmim (53,940 euro) që i korrespondonte gjendjes së tij reale në atë moment, ashtu siç përcaktohet në kontratën e datës 24 qershor 2005 dhe me kushtin që: (i) transferimi i pronësisë tek unë, të bëhet menjëherë; (ii) ABA të miratonte dhe disbursonte kredinë dhe të disbursonte direkt tek shitësi shumën prej 50,000 euro; (iii) çmimi i blerjes të paguhej në këtë mënyrë i plotë në mënyrë të menjëhershme tek zhvilluesi dhe në këtë mënyrë, apartamenti i regjistruar në pronësi timen, të vendosej menjëherë si hipotekë në favor të bankës për të garantuar shlyerjen e kredisë. Sa më sipër është pasqyruar edhe në kontratën përfundimtare të shitblerjes, ku përcaktohet qartazi se blerësi ka marrë në dorëzim apartamentin, konform parametrave teknikë, menjëherë në momentin e nënshkrimit të kontratës dhe pronësia transferohet tek blerësi menjëherë.*

Me transferimin e menjëhershëm të titullit të pronësisë, punimet e mbetura kanë vazhduar në mënyrë të pavarur prej meje në vitet në vijim dhe të paktën kati i parë i apartamentit (të gjitha punimet e brendshme, përfshirë tavanin ndarës me nënçatinë dhe shkallët për në nënçati) përfunduan tërësisht në vitet 2007-2008 dhe punimet e brendshme të nënçatisë /papafingo u finalizuan disa vite më vonë. Për hir të transparencës dhe përshkrimit të saktë të këtij transaksioni dhe duke pasur parasysh që marrëdhënia preferenciale me bankën për kredinë e dhënë garantohej nga institucioni ku punoja, të dyja kontratat janë pasqyruar në mënyrë të rregullt në regjistrat e bankës dhe, po kështu, ashtu siç ju jeni në dijeni edhe në deklarinim përkatës”.

Komisioni i ka kërkuar shoqërisë “A.K” sh.p.k. të shpjegojë mospërputhjen e çmimit të blerjes në kontratën e sipërmarrjes, me çmimin në kontratën e shitblerjes.

Shoqëria “A. K”³⁵ sh.p.k. ka shpjeguar se, për shkak të modifikimeve në planet e zhvillimit të rezidencës, midis palëve është rënë dakord që apartamenti të shitej i papërfunduar, në gjendjen faktike siç ishte dhe pronësia të kalonte menjëherë në emër të blerësit, pasi pasuria do të vihej si kolateral në favor të bankës si garanci për marrjen e kredisë për blerjen e kësaj pasurie. Shoqëria ka konfirmuar deklarinimet e subjektit duke theksuar se çmimi i shitjes së apartamentit ishte ai i parashikuar në kontratën e shitblerjes në shumën 53.940 euro.

Gjithashtu Komisioni i ka kërkuar³⁶ subjektit të deklarojë dhe të dokumentojë vlerën e punimeve të kryera në këtë apartament. Subjekti ka deklaruar investimet në zëra dhe në vlerë nga viti 2012 e në vijim, duke depozituar edhe dokumentacion mbështetës. Subjekti deklaroi se punimet janë kryer sipas lejes me nr. ***, datë 13.8.2018, të lëshuar nga Bashkia Tiranë për punime të brendshme, duke bashkëlidhur lejen përkatëse.

Në lidhje me shpenzimet për këto punime dhe blerje të tjera për mobilim, në DPV-në e vitit 2018 është deklaruar një vlerë e përafërt në shumën prej 23.500 euro. Pjesa më e madhe e shpenzimeve në vlerën rreth 21.000 euro është realizuar me transaksione bankare, transferta në llogari, çeqe bankare apo pagesa nëpërmjet kartave të debitit dhe kreditit, të pasqyruara në të dhënat bankare.

Komisioni, nga verifikimi i të dhënave bankare, vëren se janë kryer një sërë transfertash dhe pagesa për punime apo blerje materiale.

8.3 Burimi i krijimit

³⁵ Me shkresën nr. *** prot., datë 6.8.2020.

³⁶ Me pyetësin e datës 21.7.2020.

Në DPV-në e vitit 2012, subjekti ka deklaruar këtë pasuri në pronësi të bashkëshortit, blerë në shumën 53.940 euro, me burim krijimi kredinë në shumën 52.122 euro marrë në “Intesa Sanpaolo Bank”. Deklarimi i burimit të krijimit në DPV-në e vitit 2012, përputhet me deklarinin në deklaratën *Vetting*.

Në lidhje me deklarinimet e subjektit, ka rezultuar se personi i lidhur/bashkëshorti ka nënshkruar kontratë kredie bankare nr. *****/rep/kol., datë 29.6.2005, në shumën 50.000 euro për blerjen e një apartamenti.

Gjithashtu ka rezultuar se blerësi ka nënshkruar një kontratë hipotekimi nr. *****/rep/kol., datë 29.6.2005 për vendosjen në hipotekë në favor të Bankës Amerikane të pasurisë apartament me sip. 210.8 m² me qëllim garantimin e kredisë nr. *****/rep/kol., datë 29.6.2005, në shumën 50.000 euro.

8.4 Analiza financiare

Duke qenë se kjo pasuri është blerë nga z. F.P përpara lidhjes së martesës me subjektin, për efekt të analizës financiare është analizuar vetëm mundësia e pagesave të kredisë nga subjekti dhe bashkëshorti nga viti 2012 e në vijim (pas martese). Nga analizimi i të dhënave të dokumentuara, duket se subjekti dhe bashkëshorti kanë pasur mundësi financiare për të mbyllur para kohe kredinë. Kredia është shlyer tërësisht në vitin 2013, kohë në të cilën subjekti ka qenë e martuar me z. F. P.

8.5 Në konkluzion, trupi gjykues, në analizë të deklarinimeve të subjektit në deklaratën *Vetting*, dhe në deklaratat periodike, pasi shqyrtoi dhe analizoi provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit dhe ato të administruara gjatë hetimit, konstaton se subjekti ka deklaruar me vërtetësi dhe saktësi, në përputhje me nenin D të Aneksit të Kushtetutës, ekzistencën e kësaj pasurie, mënyrën e fitimit, si dhe ka pasur burime të mjaftueshme financiare për shlyerjen e kredisë bankare dhe mbylljen e saj para afatit, e cila ka shërbyer si burim për blerjen e kësaj pasurie.

9. Bashkëshorti i subjektit, zotërues i 33.3 % të një apartamenti³⁷, në bashkëpronësi me nënën, N. P (L) dhe vëllanë I. P me sipërfaqe 90 m² (86.80) në Rr. “F. R”, Tiranë.

Pjesa në përqindje: 33.3 % në pronësi të bashkëshortit. Pasuri e fituar para martese.

Burimi i krijimit: privatizimi i ish-apartamenteve shtetërore pas vitit 1992.

Deklarimi në DPV: në DPV-në e vitit 2012, deklarohet bashkëpronar me 33.3 % në bashkëpronësi me nënën e vëllain, me burim privatizimin e ish-apartamenteve shtetërore në vitin 1992.

Mënyra e fitimit: subjekti ka shpjeguar se apartamenti është i regjistruar në emër të nënës N. P(e ve). Në momentin e privatizimit z. F. P ka qenë në moshë minore.

9.1 Faktet e rezultuara nga hetimi administrativ

ZVRPP-ja Tiranë³⁸ nuk ka konfirmuar se kjo pasuri është në emër të z. F.P.

Subjekti ka deklaruar se kjo pasuri rezulton në emër të nënës së bashkëshortit, si pasojë e privatizimit të ish-banesave shtetërore.

✓ Subjekti ka deklaruar saktë pasurinë.

³⁷ Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës certifikatë për vërtetim pronësie nr. *****, datë 19.2.2008, në emër të znj. N. Xh. P për apartament me sip. 90 m² në Rr. “F. R” Tiranë.

³⁸ Me shkresën nr. ***** prot., datë 20.2.2019.

10. Bashkëshorti i subjektit, zotërues i 45.58 % të kuotave të shoqërisë “T.P” sh.p.k., themeluar në vitin 2011 me adresë në Rr. “I.R”, S. T *.**

Vlera e deklaruar: 67.000 lekë.

Pjesa në përqindje: 45.58 % e kapitalit të shoqërisë në pronësi të bashkëshortit të subjektit. Pjesëmarrja në këtë shoqëri para martesë.

Burimi i krijimit: krijuar nga ndarja ligjore dhe financiare e shoqërisë “Z.K & T” sh.p.k., ku z. F.P zotëron 20 % të kapitalit, e cila u themelua në vitin 2009 dhe u nda në dy shoqëri tregtare (njëra prej të cilave “T.P” sh.p.k.) në vitin 2011. Subjekti ka deklaruar martesën në maj të vitit 2012.

Mënyra e fitimit: nëpërmjet krijimit të një shoqërie nga ndarja e një shoqërie të mëparshme.

Shoqëria “T. P” sh.p.k., në gusht të vitit 2012 ka themeluar degën në Kosovë “T P” sh.p.k., Dega Kosovë.

Bashkëlidhur deklaratës subjekti ka depozituar dokumentacionin, si vijon:

- vërtetim i datës 24.1.2017, lëshuar nga shoqëria “T. P” sh.p.k. për zotërimin e 45.58 % të pjesëve të kapitalit nga z. F. P, i cili ushtron njëkohësisht edhe detyrën e partnerit menaxhues dhe avokatit në Shqipëri. Prej themelimit të saj në vitin 2012, ushtron edhe detyrën e Drejtorit të Degës në Kosovë dhe drejton e ushtron profesionin e tij në Republikën e Kosovës. Nga viti 2013 z. F.P zotëron leje qëndrimi dhe leje pune në Republikën e Kosovës;
- konfirmimet e pagave mujore dhe vjetore për vitet 2011 – 2016, si dhe shumat e dividendëve të miratuar nga Asambleja e Ortakëve të Shoqërisë sipas legjislacionit tregtar;
- certifikatë nga Dhoma Kombëtare e Avokatëve për licensë avokatie nr. ****, datë 4.12.2004, nga z. F. P;
- certifikatë regjistrimi e personit të tatueshëm “T.P” sh.p.k. me afat veprimtarie prej datës 14.4.2011;
- ekstrakt historik nga QKB-ja i të dhënave të subjektit “T.P” sh.p.k. me datë regjistrimi 6.6.2011, ku ortaku F.P zotëron 45.58 % të kuotave. Objekti i aktivitetit, konsulencë në fushën e drejtësisë dhe ligjit, etj. Kapitali i shoqërisë 147.000 lekë;
- vendime të Asamblesë së Përgjithshme të ortakëve të shoqërisë “T.P” sh.p.k. në vite për shpërndarje dividenti;
- pasqyrat financiare të shoqërisë “T. P” sh.p.k. në vite, shoqëruar me raportet e audituesve të pavarur;
- vendim datë 21.9.2016 nga Republika e Kosovës, Ministria e Punëve të Brendshme, Departamenti për Shtetësi, A dhe M për leje qëndrimi të përkohshëm në Republikën e Kosovës të z. F.P deri më 20.9.2017;
- certifikatë regjistrimi nr. **** dhe e numrit fiskal ***** për shoqërinë “T. P” sh.p.k. – Dega Kosovë me nr. fskal *****;
- pasqyrat financiare të shoqërisë “T. P” sh.p.k. – Dega Kosovë certifikuar nga audituesi i pavarur në vite.

10.1 Faktet e rezultuara nga hetimi administrativ

QKB-ja³⁹ ka konfirmuar se shtetasi F. P figuron ortak, zotërues i 45.58 % të kuotave në shoqërinë “T. P” sh.p.k., regjistruar në QKB me NIPT L****V, regjistruar në datën 6.6.2011. Bashkëlidhur shkresës ekstrakti historik.

QKB-ja ka konfirmuar gjithashtu se z. F. P ka qenë ortak, zotërues i 20 % të kuotave në shoqërinë “Z.K & T” sh.p.k., regjistruar në QKB me NIPT K****N. Aktualisht ky subjekt figuron me status të çregjistruar.

Komisioni ka hetuar nëse subjekti⁴⁰ ka pasur çështje në hetim/të regjistruara, ku shoqëria “T& P” sh.p.k. të ketë qenë me cilësinë e përfaqësueses ligjore për ndonjë person apo shoqëri.

Subjekti ka shpjeguar se nuk ka pasur çështje në hetim apo të regjistruara ku shoqëria “T& P” sh.p.k., të ketë qenë përfaqësuese ligjore për ndonjë person fizik apo juridik.

Në mbështetje të këtyre pretendimeve subjekti ka depozituar:

- shkresë nr. *** prot., datë 11.9.2020, lëshuar nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Krujë;
- shkresë nr. **** prot., datë 11.9.2020, lëshuar nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë;
- shkresë nr. **** prot., datë 11.9.2020, lëshuar nga Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar;

Të tria këto institucione kanë konfirmuar se gjatë periudhës së ushtrimit të funksionit të prokurores, znj. Pranvera Pustina nuk ka rezultuar që të ketë shqyrtuar çështje të regjistruara në emër të shoqërisë tregtare “T. P” sh.p.k.

10.2 Trupi gjykues, në analizë të deklaratimeve të subjektit në deklaratën *Vetting*, pasi shqyrtoi dhe analizoi provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit dhe ato të administruara gjatë hetimit, konstaton se subjekti ka deklaruar me vërtetësi dhe saktësi, në përputhje me nenin D të Aneksit të Kushtetutës, ekzistencën e këtyre kuotave, mënyrën e fitimit, si dhe burimin e krijimit të saj.

11. Bashkëshorti i subjektit, zotërues i 100 % të kuotave të kapitalit të shoqërisë “D” sh.p.k., krijuar në vitin 2008, shoqëri pa aktivitet dhe pa të ardhura

Vlera e deklaruar: 100.000 lekë.

Pjesa në përqindje: 100 % në pronësi të bashkëshortit të subjektit. Pjesëmarrje në këtë shoqëri para martese.

Burimi i krijimit: krijuar me të ardhurat personale.

11.1 Faktet e rezultuara nga hetimi administrativ

QKB-ja⁴¹ konfirmon se shtetasi F. P figuron ortak i vetëm dhe administrator me afat të përfunduar (datë 5.8.2011) në shoqërinë “D” sh.p.k., regjistruar me NIPT K*****O. Nga verifikimi i kryer nga Komisioni, në faqen zyrtare të QKB-së, rezulton se kjo shoqëri është me status aktiv. Objekti i veprimtarisë së saj janë investime në pasuritë e paluajtshme, shërbime pasurish të paluajtshme, menaxhimi, dhënia me qira dhe shitja e tyre.

DRT-ja Tiranë⁴² konfirmon se shtetasi F.P është i regjistruar si administrator i subjektit “D” sh.p.k. me aktivitet “agjencitë e pasurive të patundshme”, i cili aktualisht në sistemin tatimor figuron me statusin pasiv nga data 24.10.2012.

³⁹ Me shkresën nr. **** prot., datë 25.2.2019.

⁴⁰ Me pyetësorin e datës 9.9.2020.

⁴¹ Me shkresën nr. **** prot., datë 25.2.2019.

⁴² Me shkresat me nr. ****, datë 7.8.2017; 693/26, datë 28.8.2017; ****a , datë 7.9.2017, drejtuar ILDKPKI-së.

✓ Deklarimi i subjektit përputhet me dokumentacionin e adminisistruar.

12. Aktivitet “bar-kafe”, themeluar në vitin 2013, si Person Fizik⁴³ F.P, kapital i palikuidueshëm, me NIPT L***K.**

Pjesa në përqindje: 100 % në pronësi të bashkëshortit të subjektit. Personi Fizik regjistruar para martese.

Burimi i krijimit: të ardhurat personale të deklaruara dhe të tatuara.

Deklarimi në DPV: Në DPV-në e vitit 2013 nuk është deklaruar burim⁴⁴.

QKB-ja⁴⁵ ka konfirmuar se shtetasi F. P figuron të jetë regjistruar si Person Fizik me NIPT L*****K. Nga verifikimi i kryer nga Komisioni në faqen zyrtare të QKB-së, Personi Fizik rezulton me status aktiv. Objekti i veprimtarisë së saj është lokal, bar, klub nate.

DRT-ja Tiranë⁴⁶ ka konfirmuar se shtetasi Floran Pustina është i regjistruar si tatimpagues me subjektin F. P, Person Fizik, me NIPT L*****K, i cili aktualisht në sistemin tatimor figuron me statusin pasiv nga data 26.5.2017.

✓ Deklarimi i subjektit përputhet me përgjigjet e ardhura nga QKB-ja dhe DRT-ja.

Komisioni ka hetuar në lidhje me statusin aktual në DRT Tiranë dhe QKB, si dhe për fitimet e gjeneruara nga keto subjekte tatimore nga viti 2016 e në vijim, për subjektet tregtare: “C. J.E” sh.p.k., “D” sh.p.k., “G. *” sh.p.k. si dhe “F.P” Person Fizik.

Sipas informacionit të dhënë nga personi i lidhur/bashkëshorti F.P, subjekti ka shpjeguar⁴⁷ si vijon: *“Shoqëria ‘D’ sh.p.k., shoqëri kjo e deklaruar në mënyrë të rregullt në deklarin periodik në ILDKPKI. Shoqëria nuk ka pasur asnjëherë aktivitet tregtar dhe nuk ka pasur asnjëherë shitje, fitim dhe si rrjedhim nuk ka shpërndarë asnjëherë fitim/divident. Aktualisht është në gjendje pasive në DRT. Bashkëlidhur si shtojca 4/1 do të gjeni profilin e tatimpaguesit, ekstraktuar nga DPT-ja.*

Shoqëria ‘G.’ sh.p.k., pjesëmarrja në shoqëri dhe largimi nga shoqëria në vitin 2018 janë deklaruar në mënyrë të rregullt në deklarinet periodike vjetore në ILDKPKI. Nga të dhënat depozituar në QKB nga përfaqësuesit ligjorë të saj, shoqëria nuk ka shpërndarë fitime për ortakët e saj as për vitin 2016 dhe as për vitin 2017. Për vitin 2016, fitimi prej 67,025 lekësh i shoqërisë ka kaluar për investime dhe shoqëria nuk ka shpërndarë fitim për ortakët. Për vitin 2017, fitimi i shoqërisë prej 5,272,018 lekësh ka kaluar për investime dhe nuk është shpërndarë fitim për ortakët. Që nga shtatori i vitit 2018 F. P nuk ka zotëruar më kuota në shoqëri.*

Shoqëria ‘C. J. E’ (Q.K. T): Pjesëmarrja në të në vitin 2015 është deklaruar në mënyrë të rregullt në deklarinet periodike vjetore në ILDKPKI. Nga të dhënat e depozituara në QKB nga përfaqësuesit ligjorë të shoqërisë: shoqëria nuk ka shpërndarë fitime për ortakët e saj. Për vitin 2016 nuk ka pasur fitim dhe, si rrjedhim, nuk ka shpërndarë divident; për vitin 2017 shoqëria nuk ka pasur fitim dhe, si rrjedhim, nuk ka shpërndarë divident; për vitin 2018 shoqëria ka realizuar një fitim prej 18,532 lekësh, por nuk ka shpërndarë asnjë fitim/divident për ortakët e saj.

‘F. P’ regjistruar Person Fizik, themelimi i saj është deklaruar në mënyrë të rregullt në deklarin periodik vjetor në ILDKPKI. Në vitin 2016 fitimi ka qenë 67,758 lekë dhe Personi

⁴³ Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratën bilancin e vitit 2015 datë 10.2.2016.

⁴⁴ Referuar ligjit nr. 9901/2008, “Për tregtarët e shoqëritë tregtare” i ndryshuar, nuk nevojitet kapital fillestar për të regjistruar një person fizik.

⁴⁵ Me shkresën nr. **** prot., datë 25.2.2019.

⁴⁶ Me shkresat nr. **** prot., datë 7.8.2017 dhe 693/26 prot., datë 28.8.2017, drejtuar ILDKPKI-së.

⁴⁷ Në përgjigjet e pyetësorit të datës 14.9.2020.

Fizik nuk ka pasur më aktivitet tregtar pas vitit 2016. Aktualisht është në gjendje pasive në DRT”.

Subjekti, shpjegimeve të dhëna u ka bashkëlidhur shtojcën 4/2, ku ka rezultuar profili i tatimpaguesit, ekstraktuar nga DPT-ja, ku duket se subjekti tatimpagues “D” sh.p.k., dhe Personi Fizik “bar-kafe” themeluar në vitin 2013, rezultojnë me status pasiv ose pa aktivitet.

Gjithashtu, subjekti u pyet nga Komisioni nëse ka pasur çështje në hetim/të regjistruara për personat R.P, Q.Gj, E.D, E. S, G.Z, ortak apo ish-ortak në shoqëritë tregtare, ku bashkëshorti i subjektit është/ka qenë zotërues kuotash.

Subjekti ka shpjeguar⁴⁸ se nuk ka pasur asnjë çështje në hetim apo të regjistruar ndaj personave të sipërpërmendur.

Subjekti, në mbështetje të shpjegimeve të saj, ka depozituar:

- shkresë nr. **** prot., datë 11.9.2020, lëshuar nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë;
- shkresë nr. **** prot., datë 11.9.2020, lëshuar nga Prokuroria pranë Gjykatës së Parë Krujë;
- shkresë nr. **** prot., datë 11.9.2020, lëshuar nga Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar, Tiranë.

Të tria këto institucione kanë konfirmuar se gjatë periudhës së ushtrimit të funksionit të prokurores, znj. Pranvera Pustina, nuk ka pasur çështje në hetim/të regjistruara ndaj shtetasve R. P, Q. Gj, E. D, E. S, G.Z dhe shoqërinë “T & P” sh.p.k.

Likuiditetet në llogaritë bankare

13. Llogari rrjedhëse⁴⁹ me nr. ***, në BKT**

- në euro shumën 131.158 euro;
- në lekë në shumën 132.407 lekë.

Nga verifikimi i të dhënave bankare ka rezultuar se këto likuiditete janë krijuar nga aktiviteti i bashkëshortit të subjektit me burim të ardhurat nga pagat dhe shpërblimet, për periudhën 2012 – 2016, nga punësimi në shoqërinë “T.P” sh.p.k.

13.1 Faktet e rezultuara nga hetimi administrativ

BKT-ja⁵⁰ ka konfirmuar gjendjen e kësaj llogarie:

- llogaria në euro, në shumën 130.789 euro, datë 30.1.2017;
- llogaria në lekë, në shumën 35.667 lekë, datë 30.1.2017.

✓ Deklarimi i subjektit përputhet me dokumentacionin e depozituar dhe me të dhënat e ardhura nga BKT-ja.

14. Llogari rrjedhëse⁵¹ në BKT, Dega Kosovë në shumën 195.076 euro

Nga verifikimi i të dhënave bankare ka rezultuar se këto likuiditete janë krijuar me burim të ardhurat nga pagat dhe shpërblimet, për periudhën 2012 – 2016, nga punësimi në shoqërinë “T. P” sh.p.k.

⁴⁸ Me përgjigjet e pyetësorit të datës 14.9.2020.

⁴⁹ Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratën vërtetimin nr. ****, datë 26.1.2017, nga BKT-ja për shumën e deklaruar të llogarisë:
- 131.158 euro.
- për gjendjen e llogarisë në shumën 35.667 lekë.

⁵⁰ Me shkresën nr. ****, datë 10.7.2017, drejtuar ILDKPKI-së.

⁵¹ Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratën: vërtetim datë 25.1.2017 nga BKT-ja, Dega Pajton, Prishtinë, për shumën e deklaruar 195.076 euro, datë 25.1.2017.

✓ Deklarimi i subjektit përputhet me dokumentacionin e depozituar në dosje.

15. Llogari e kursimit F⁵², në “Intesa Sanpaolo Bank”, në emër të vajzës, M. P.

- në lekë, shumën 525.109 lekë;
- në euro, shumën 102.12 euro.

Nga verifikimi i të dhënave bankare, këto likuiditete janë krijuar me burim të ardhurat nga pagat.

✓ Deklarimi i subjektit përputhet me dokumentacionin e ardhura nga BKT-ja.

15.1 Nga hetimi administrativ ka rezultuar se “Intesa Sanpaolo Bank”⁵³ ka konfirmuar gjendjen në datën 30.1.2017, në shumën 525.109 lekë dhe në shumën 102.12 euro.

✓ Deklarimi i subjektit përputhet me dokumentacionin e adminisistruar në dosje.

16. Llogari rrjedhëse, në emër të z. F.P, në “Intesa Sanpaolo Bank”:

- në euro, në shumën 2.438 euro;
- në lekë, në shumën 6.336 lekë;
- në euro -18.30 euro.

Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës *statement* bankar datë 25.1.2017, për shumat e deklaruara 6.336 lekë, 2.438 euro dhe -18.3 euro.

“Intesa Sanpaolo Bank”⁵⁴ ka konfirmuar llogari rrjedhëse në emër të z. F. P në euro dhe lekë në datën 30.1.2017, në shumat 6.336 lekë, 2.438 euro dhe -18.3 euro.

✓ Deklarimi i subjektit përputhet me dokumentacionin e administruar në dosje.

Në konkluzion, Komisioni, pasi shqyrtoi dhe analizoi provat e administruara gjatë hetimit dhe ato të dërguara nga subjekti i rivlerësimit, arrin në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të saktë dhe në përputhje me ligjin. Të ardhurat e reflektuara në analizën financiare të Komisionit janë të ardhura, të cilat janë deklaruar dhe janë paguar detyrimet tatimore në përputhje me pikën 3, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës. Për pasojë, subjekti dhe bashkëshorti kanë burime të mjaftueshme financiare për blerjet e kryera në vite.

17. Të tjera fakte të rezultuara gjatë hetimit

Komisioni ka pyetur⁵⁵ subjektin nëse zotërojnë pasuri të paluajtshme apo të luajtshme të regjistruara në regjistrat publikë, në Shqipëri dhe në Kosovë, shoqëritë tregtare apo degë të shoqërisë, ku personi i lidhur/F. P është ortak.

Personi i lidhur ka shpjeguar⁵⁶ se: “*Deri në datën e deklaramit të formularit për vlerësimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve, shoqëria ‘T. P’ sh.p.k. dhe dega e saj në Kosovë nuk kanë pasur në pronësi pasuri të paluajtshme.*

*Në nëntor dhe dhjetor 2018, blerje e pasurisë së paluajtshme ZYRË, me një sipërfaqe prej 215 m², në shumën prej 650.000 euro, me adresë Bulevardi Dëshmorët e Kombit, K. B, Qendra Tregtare kati **, ‘T. P’ sh.p.k. ka realizuar me numër identifikimi pasurie ***-N***, z. k. ***, vol. **, f. **. Blerja është realizuar nëpërmjet: (i) financimit të dhënë nga ‘Intesa Sanpaolo*

⁵² Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës: *statement* datë 25.1.2017 nga “Intesa Sanpaolo Bank” për shumën e dekluar 525.109 lekë dhe 102.12 euro.

⁵³ Me shkresën nr. *** prot., datë 4.7.2017.

⁵⁴ Me shkresën nr. *** prot., datë 4.7.2017 drejtuar ILDKPKI-së.

⁵⁵ Me pyetësorin e datës 13.5.2020.

⁵⁶ Në përgjigjet e datës 26.5.2020.

Bank' (kredi afatgjatë 15-vjeçare) në shumën EUR 550.000; dhe (ii) pagesë nga llogaritë e shoqërisë në shumën prej EUR 100.000.

Disa nga asetet e tjera të luajtshme të shoqërisë ndër vite kanë qenë automjete, të cilat përdoren nga shoqëria, dega e shoqërisë dhe punonjësit e shoqërisë, kryesisht për nevoja pune. Bashkëlidhur do të gjeni llogarinë e kontabilitetit të shoqërisë për vitin financiar 2016, e cila përmbledh edhe asetet e luajtshme, që regjistrohen në regjistra të veçantë, përgatitur nga konsulentët financiarë dhe të taksave të shoqërisë”.

18. Në lidhje me adresat e banimit të deklaruara nga subjekti në DPV

Subjekti i rivlerësimit ka filluar detyrën më 15.10.2010 dhe ka deklaruar si adresë të regjistruar të gjendjes civile:

- në deklaratën para fillimit të detyrës, depozituar më 2.11.2010, subjekti ka deklaruar si adresë: Rr. “H. Ce”, p. ****, Tiranë;
- në DPV-në e vitit 2010, adresa: Rr. “H. C”, p. ***, Tiranë;
- në DPV-në e vitit 2011, adresa: Rr. “H. C”, p. ***, Tiranë;
- në DPV-në e vitit 2012, adresa e plotë e gjendjes civile: Rr. “F. R”, p. ***, ap. **, Tiranë dhe si adresë tjetër banimi është dhënë rezidenca: “K.D”, Selitë, Farkë, nr. i pasurisë ***, ****, vol. ***, f. ***.

Nga hetimi i kryer nga Komisioni ka rezultuar:

ZVRPP-ja Tiranë⁵⁷ ka informuar se në emër të z. R. H (babai i subjektit) rezulton një pasuri me nr. ****, vol. **, f. ***, z.k. ***, lloji i pasurisë apartament (pasuri e transkriptuar). Bashkëlidhur përgjigjes është administruar kontrata e shitblerjes me nr. *** rep., nr. *** kol., datë 30.5.1997, sipas së cilës z. R. H ble nga shtetasi A. M apartamentin me sip. 54 m², në adresën: Rr. “H.C”, p. ***, shk.***, ap. ***, Tiranë, në çmimin 1.250.000 lekë.

Referuar dokumentacionit të ardhur ka rezultuar se në apartamentin ekzistues është ndërtuar një shtesë anësore me sip. 26.77 m² e legalizuar sipas lejes së legalizimit me nr. ****, datë 6.5.2013. Referuar dokumentacionit të ardhur nga ALUIZNI, ka rezultuar që shtesa referuar formularit të vetëdeklarimit është me nr. **** prot., datë 14.11.2006 dhe vlera e investimit të shtesës anësore është rreth 800.000 lekë. E gjithë praktika e kryer pranë ALUIZNI-t dhe pagesat e kryera janë në emër të babait të subjektit, z. R. H. H.

Nga verifikimi i kryer kjo pasuri apartament + shtesë anësore ka rezultuar e shitur nga prindërit e subjektit në datën 25.8.2015.

UKT-ja⁵⁸ ka informuar se shtetasi R. H ka lidhur një kontratë për furnizim me ujë të pishëm në adresën: Rr. “Gjergj Elez Alia”, Yzberisht Tiranë. Bashkëlidhur përgjigjes ka rezultuar një kontratë porosie me nr. *** rep., nr. *** kol., datë 24.1.2008, sipas së cilës, porositi apartamentin me sipërfaqe 56.4 m², në çmimin 30.000 euro.

ZVRPP-ja Tiranë⁵⁹ nuk e konfirmon pronësinë e kësaj pasurie.

Subjekti i rivlerësimit, në shpjegimet⁶⁰ e dhëna në lidhje me kontratën e porosisë nr. ***rep., nr. ** kol., datë 24.1.2008, ka sqaruar: “... nga ana ime është pyetur im atë R. H. H i cili ka deklaruar se kontratat e mësipërme me UKT-në nuk janë lidhur nga ana e tij, por nga një person tjetër, i cili ka të njëjtat gjeneralitete si im atë. Dëshiroj të sqaroj se im atë, ka të dhënat

⁵⁷ Me shkresën nr. *** prot., datë 20.2.2019.

⁵⁸ Me shkresën nr. *** prot., datë 13.2.2019.

⁵⁹ Me shkresën nr. *** prot., datë 20.2.2020.

⁶⁰ Mbi rezultatet e hetimit të dërguara nga Komisioni të datës 6.10.2020.

identifikuese si vijon: z. R.H, i biri i H dhe S, i datëlindjes 10.6.1951, lindur në Tosk Martallos, Tepelenë, identifikuar me letërnjoftim nr. **** dhe nr. personal F****K.

Ndërkohë, rezultatat e hetimit administrativ, të cilat me të drejtë janë mbështetur mbi përgjigjen e ZRVPP-së Tiranë, lidhen me një shtetas tjetër, i cili ka gjeneralitete të njëjta me tim atë. Ky shtetas është R. H, i biri i H dhe S, i datëlindjes 1.9.1951, lindur në Buz-Kalemaj, Tepelenë, identifikuar me letërnjoftim nr. *** dhe nr. personal F***O. Ky fakt provohet nga fotokopjet e kartës së indentiteti bashkëlidhur këtyre sqarimeve”.

Me gjithë shpjegimet e dhëna nga subjekti, Komisioni vlerëson se pasuria⁶¹ dhe shtesa anësore janë blerë/ndërtuar nga babai i saj përpara se subjekti të fillonte detyrën si magjistrate. Për këtë arsye, nuk ka shkak të arsyeshëm për të ngritur dyshime.

ZVRPP-ja Tiranë⁶² ka informuar gjithashtu se shtetasi R. H zotëron pasurinë apartament me sip. 67.35 m², blerë sipas kontratës së shitblerjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 30.6.2016, nga shoqëria “A. K” sh.p.k., në shumën 50.085 euro.

19. Detyrime financiare

Nga verifikimi i deklaratës *Vetting* u evidentua fakti që subjekti nuk ka deklaruar detyrimin e mbetur në lidhje me pagesën e këstit të dytë të parashikuar në “kontratën për kalim të drejtash” në vlerën prej 30.000 euro, për likuidimin e plotë për pasurinë e blerë.

Komisioni, në seancën dëgjimore të datës 9.10.2020, i ka kërkuar shpjegime subjektit, i cili deklaroi se kësti i dytë nuk është paguar ende dhe do të deklarohet në momentin e likuidimit.

Trupi gjykues, në vlerësim të të gjitha rrethanave dhe provave, e vlerësoi si një pasaktësi në deklaram në deklaratën *Vetting*, pasi ky detyrim duhet të ishte deklaruar në rubrikën përkatëse të formularit të deklaramit.

Konkluzion përfundimtar mbi pasurinë

Nga vlerësimi në tërësi i pasurisë së subjektit të rivlerësimit vërehet se subjekti ka deklaruar saktë pasurinë dhe nuk janë konstatuar elemente, që mund të ngrenë dyshime për fshehje apo deklaram të rremë nga subjekti i rivlerësimit. Deklarimet e subjektit të rivlerësimit janë të mjaftueshme. Pas verifikimit, deklaramet e subjektit rezultojnë të sakta dhe në përputhje me ligjin. Subjekti ka burime të ligjshme financiare për krijimin e tyre.

⁶¹ Referuar apartamentit blerë në vitin 1997.

⁶² Me shkresën nr. **** prot., datë 20.2.2020.

Pershkrimi	2008-2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016
PASURI	701 461	498 286	13 572 719	10 484 508	19 548 004	15 402 870	2 804 151
Apartament sip 210,7 m2, Tirane blere ne maj 2005 nga b/sh i SR							
Automjet BMW blere nga b/sh per SR				897 344			
40% te kuotave te G 3 SHPK (07.02.2014)					1 128 000		
20% te aksioneve te C.J. E.						40 000	
Autoveture BMW AA546ME						4 008 315	
Ullishte 8.700 m2 ne Mumajes, Tirane							3 719 925
Apartament ne Qerret, 107.4 m2							4 599 180
DIFERENCE LIKUIDITETI (DIF. LIK. - LIKUIDITETE VITI PARAARDHES)	701 461	498 286	13 572 719	9 587 164	18 420 004	11 354 555	-5 514 954
LIKUIDITETE (FUND VITI Dok.)	701 461	1 199 747	14 772 466	24 359 630	42 779 633	54 134 189	48 619 235
Gjendje cash SR	700 000	1 200 000					
Likuiditete ne banke SR	1 461	-253	29 314	21 460	396 287	466 014	2 083 652
Likuiditete ne banke B/Sh			10 341 972	19 432 969	37 465 260	48 737 505	45 996 676
Likuiditete te vazjes M. P				504 021	516 906	529 490	538 907
Cash b/sh			4 401 180	4 401 180	4 401 180	4 401 180	
DETYRIME	0	0	5 643 301	-5 643 301	0	-206 475	1 758 510
Kredi e marre ne maj 2005 per blerje apartamenti			5 643 301	-5 643 301			
Hua dhene Kompanise G 3						-206 475	
Detyrim per apartamentin ne Qerret							4 734 450
Hua dhene kompanise T & P shpk							-2 975 940
PASURI NETO (PASURI - DETYRIME)	701 461	498 286	7 929 418	16 127 809	19 548 004	15 609 345	1 045 641
TE ARDHURA dokumentuar	1 207 361	841 881	12 589 420	46 242 467	48 121 920	34 790 357	20 186 547
Te ardhura Subjekti	1 207 361	841 881	958 253	392 648	1 058 897	962 380	2 272 013
Te ardhura b/sh	0		11 484 461	45 837 064	47 050 327	32 783 307	17 024 610
Te ardhura nga interesat e depozitave				12 755	12 696	11 852	37 723
Shperblim i lindjes						5 000	
Rimbursim i TVSH nga shteti Gjerman per blerjen e autovetures						412 950	
Te ardhura nga shitja e makines							852 201
Te ardhura nga aktiviteti Personi Fizik "F. P"						614 869	
Te ardhura nga dhurimet per dasmen			146 706				
SHPENZIME	597 254	196 089	1 820 259	3 059 791	1 862 117	6 306 846	5 265 850
Shpenzime jetese	409 860	136 620	282 048	423 072	659 994	672 828	940 368
Shpenzime udhetimi	187 394	59 469	406 563	1 023 896	1 149 623	472 046	1 743 147
Shpenzime keste kredie dhe komisione ISP Albania			605 626	280 827			
Shpenzime spitali Amerikan/Hygeia			526 022		52 500	684 193	11 293
Shpenzime mobilimi				1 331 995		440 000	
Punime rikonstruksioni e investime ne apartament / dhe pasurine ullishte (2016)						1 503 070	426 101
Shpenzime shkollimi femijet (pyetesor standard)						1 166 807	795 388
Shpenzime ne gjermani per blerjen e makines						323 478	
Ndihme financiare per nje mik te familjes						619 425	
Pushime brenda vendit						425 000	
Pagese tatimi DIVA 2015							1 349 553
Rezultati financiar	-91 354	147 506	2 839 743	27 054 868	26 711 799	12 874 165	13 875 056

Analiza financiare përmbledhëse

B. KONTROLLI I FIGURËS

Drejtoria e Sigurisë së Informacionit të Klasifikuar (DSIK) ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, me qëllim identifikimin nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin Dh të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016.

DSIK-ja ka dërguar një raport⁶³ në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016, ku ka konstatuar përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës të znj. Pranvera Pustina.

Hetimi i kryer nga Komisioni

DSIK-ja⁶⁴, bazuar në kërkesën e Komisionit për të përditësuar informacionin në lidhje me figurën e subjektit Pranvera Pustina, ka informuar se nuk ka të dhëna apo informacione shtesë nga institucionet verifikuese, pas datës 31.10.2017, që mund të përfshihen në raportin e figurës.

Komisioni ka kërkuar informacion pranë Prokurorisë së Përgjithshme në lidhje me procedime disiplinore apo penale të regjistruara, të mosfilluara apo të pushuara, në emër të subjektit.

Prokuroria e Përgjithshme⁶⁵ ka informuar se për subjektin e rivlerësimit, znj. Pranvera Pustina, nuk rezultojnë të ketë masa disiplinore në karrierën e saj.

Për sa më sipër, nga hetimi i kryer nuk u evidentua ndonjë e dhënë për të ngritur dyshime në lidhje me figurën.

Konkluzion për vlerësimin e kontrollit të figurës

Nga hetimi administrativ i kryer nga Komisioni nuk u gjetën elemente që të vërtetojnë ekzistencën e kontakteve të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar apo përfshirje e subjektit të rivlerësimit në veprime korruptive sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës.

✓ Trupi gjykues arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit, znj. Pranvera Pustina, ka arritur një nivel të besueshëm në kontrollin e figurës.

C. VLERËSIMI PROFESIONAL

Hetimi i Komisionit lidhur me këtë kriter është bazuar në analizimin e:

- raportit të hartuar nga Këshillit i Lartë i Prokurorisë (KLP) për analizimin e aftësisë profesionale të subjektit të rivlerësimit;
- kriterëve të vlerësimit të parashikuara në ligjin nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (neni 71 e vijues i tij);
- denoncimeve të paraqitura sipas nenit 53 të ligjit nr. 84/2016.

Përvoja profesionale në 10 vitet e fundit

Prokurorja Pranvera Pustina, subjekt rivlerësimi: për periudhën tetor 2010 - nëntor 2011 ka ushtruar funksionin e prokurorit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë (periudha e stazhit profesional); për periudhën nëntor 2011 – tetor 2015 ka ushtruar funksionin në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Krujë; për periudhën janar 2015 - prill 2015 ka ushtruar funksionin e prokurorit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë (komandim); për periudhën

⁶³ Me nr. *** prot., datë 31.10.2017.

⁶⁴ Me shkresën nr. *** prot., datë 7.7.2020.

⁶⁵ Me shkresën nr. *** prot., datë 7.7.2020.

shkurt 2016 - deri në vijim ka ushtruar funksionin e prokurorit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krimet e Rënda, Tiranë.

Të dhëna nga burime arkivore

Prokuroria e Përgjithshme, sektori protokoll/arkiv⁶⁶ ka informuar se, nga kontrolli i ushtruar në regjistrat e kallëzimeve dhe procedimeve penale të Prokurorisë së Përgjithshme, ka rezultuar se nuk ka çështje apo kallëzim penal të filluar ndaj subjektit të rivlerësimit. Gjithashtu, nga kontrolli i ushtruar në Regjistrat e Ankesave, në mënyrë manuale, për periudhën viti 2006 – 2018, nuk ka rezultuar asnjë ankesë.

Raporti i hartuar nga KLP-ja është bazuar në tri aktet procedurale ligjore të paraqitura nga subjekti dhe në pesë dosjet e vëzhguara, të përzgjedhura me short, duke iu referuar kritereve të vlerësimit, si vijojnë:

- a) aftësitë profesionale;
- b) aftësitë organizative;
- c) etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale; dhe
- d) aftësitë personale dhe angazhimi profesional.

a) Aftësitë profesionale

Bazuar në tri aktet procedurale ligjore të paraqitura prej saj dhe në pesë dosjet e vëzhguara, të përzgjedhura me short është konstatuar se subjekti ka identifikuar drejt normën ligjore të zbatueshme në të gjitha rastet. Aktet procedurale janë të argumentuara. Subjekti i rivlerësimit, prokurori Pranvera Pustina, ka treguar korrektësi në zbatimin të ligjit, analizon normën penale dhe procedurale penale të zbatueshme, duke e harmonizuar atë me faktin penal apo rrethanat që përcaktojnë masën e dënimit. Ka rezultuar se qëndrimet e prokurorit në të gjitha rastet janë mbështetur nga Gjykata e Shkallës së Parë Tiranë, Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda dhe Gjykata e Shkallës së Parë Krujë. Niveli i arsytimit të akteve të vëzhguara respekton standardin e procesit të rregullt ligjor.

b) Aftësitë organizative

Për sa iu përket të dhënave statistikore, ngarkesa e moderuar e punës së subjektit të rivlerësimit lidhet me faktin se gjatë ushtrimit të detyrës së tij, kohës objekt rivlerësimi, subjekti është pajisur me dy leje prindërore. Në referencë të të dhënave statistikore dhe obligimeve të tij ligjore, konstatohet se prokurori ka përballuar ngarkesë pune të moderuar gjatë periudhës së rivlerësimit.

Nga vëzhgimi i pesë dosjeve gjyqësore të përzgjedhura me short, konstatohet se dosjet janë të administruara rregullisht, materialet janë të vendosura në rend kronologjik, përgjithësisht na njohin me faktin penal, me qëndrimin e prokurorit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë dhe disponimin e gjykatës.

c) Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale

Nga aktet e përzgjedhura nga subjekti si dhe nga dosjet e hedhura në short, ka rezultuar se gjuha e përdorur nga subjekti i rivlerësimit në përpilimin e akteve është në përputhje me etikën profesionale të prokurorit.

d) Aftësitë personale dhe angazhimi profesional

Subjekti i rivlerësimit, prokurori Pranvera Pustina, i nënshtrohet programit të formimit vazhdues të Shkollës së Magjistraturës. Lidhur me trajnime të tjera, subjekti i rivlerësimit, prokurori Pranvera Pustina, ka qenë pjesëmarrëse në disa aktivitete të zhvilluara si brenda ashtu edhe jashtë vendit.

⁶⁶ Me shkresën nr. *** prot., datë 4.1.2019.

Në lidhje me denoncimet nga publiku

Në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit për subjektin e rivlerësimit janë depozituar 4 denoncime. Komisioni i shqyrtoi dhe për dy prej tyre, subjektit iu kërkuan shpjegime. Në prapësime, subjekti dha shpjegime dhe depozitoi dokumentacion provues për çështjet përkatëse.

- ✓ Trupi gjykues vlerësoi shpjegimet e dhëna nga subjekti i rivlerësimit në prapësime, si dhe pasi kreu verifikimet në dosjet përkatëse, referuar pikës 2, të nenit 53, të ligjit nr. 84/2016, ka konstatuar se nuk përmbajnë fakte apo rrethana që mund të përbëjnë prova në lidhje me kriterin e rivlerësimit profesional.

Konkluzion lidhur me kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale

Në cilësinë e relatores së çështjes, nga hetimi i thellë administrativ i kryer nuk u provua asnjë *indicie* apo element që cenon figurën e prokurores Pranvera Pustina dhe sipas parashikimeve në nenin 44/a, të ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit ka treguar cilësi të pranueshme në punë, është efiçente dhe efektive në masë të pranueshme dhe, përfundimisht, propozon për kriterin profesional vlerësimin “e aftë”.

KONKLuzion Përfundimtar

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, pasi u njoh me rrethanat e çështjes, bazuar në provat e administruara, raportin dhe rekomandimet e relatorit të çështjes, si dhe pasi dëgjoi subjektin e rivlerësimit në seancën dëgjimore publike, arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit, znj. Pranvera Pustina, ka plotësuar së bashku kushtet e mëposhtme:

- a. ka arritur nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë;
- b. ka arritur nivel të besueshëm në kontrollin e figurës;
- c. ka arritur një nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale.

PËR KËTO ARSYE,

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në pikën 5, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016, pasi u mbledh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar dhe në bazë të germës “a”, të pikës 1, të nenit 58, si dhe të pikës 1, të nenit 59, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

V E N D O S I:

1. Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, znj. Pranvera Pustina, prokurore/Drejtoreshë e Kabinetit, pranë Prokurorisë së Përgjithshme.
2. Ky vendim, i arsyetuar me shkrim, i njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesit ndërkombëtar dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit, në përputhje me pikën 7, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016.
3. Ky vendim mund të ankimohej në Kolegjin e Posaçëm të Apelit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të vendimit. Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.

Ky vendim u shpall në Tiranë, në datën 14.10.2020.

ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES

Genta TAFA (BUNGO)

Kryesuese

Suela ZHEGU
Relatore

Etleda ÇIFTJA
Anëtare

Sekretare gjyqësore
Etmonda Hoxha